

ShIKÇAK

RAPORTI
VJETOR

2017



MISIONI

Misioni ynë është që të zhvillojmë dhe avancojmë një organizatë profesionale dhe konkurruese edhe në tregun ndërkombëtar, e cila përmbush standardet më të larta profesionale dhe etike, si dhe perfeksionon performancën organizative përmes menaxhimit financiar, sigurisë dhe ekspertizës së specializuar. Ne veprojmë me integritet, objektivitete dhe me përkushtim ndaj cilësisë dhe interesit publik.

VIZIONI

Vizioni ynë është të bëhemi prijës në krijimin, vlerësimin dhe interpretimin e informatave, të cilat masin dhe avancojnë performancën organizative, duke pasur për synim ofrimin e zgjedhjes sa më të mirë të menaxhimit financiar, sigurisë dhe shërbimeve tjera të specializuara.

QËLLIMI

Zhvillimi i vazhdueshëm i programit të trajnimit i krahasueshëm me programet e shoqatave profesionale më eminente të kontabilitetit. Zhvillimi dhe avancimi i bazës së anëtarësisë të njohur për ekspertizë profesionale dhe standarde të larta etike. Anëtarësimi në organizata profesionale ndërkombëtare.

ANËTARE ME TË DREJTA TË PLOTA



International Federation
of Accountants



European Federation
of Accountants and Auditors




Fédération des Experts
Comptables Méditerranéens

Përmbajtja

ShKÇAK e vendosë Kosovën në fokus të zhvillimeve globale	07
Fjala e Kryetarit	09
Mesazh nga Drejtoresha Ekzekutive	13
Vit i zgjerimit të kualifikimeve dhe ndikimit në zhvillimet vendore dhe ndërkombëtare	16
Edukimi shtyllë e rëndësishme në përmbushje të objektivave zhvillimore të vendit	18
Zbatimi i sigurimit të cilësisë për ngritje të kredibilitetit të anëtarëve	22
Avancimi i shërbimit dhe komunikimit më anëtarë	24
Zhvillimi i sistemit të raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë	26
ShKÇAK kontribuese aktive në zhvillimet vendore dhe globale të profesionit	29
Studentët e Vitit 2017	55
Komisionet e Shoqatës	56
Përmbledhje e të gjeturave dhe rekomandimeve nga raporti Dashboard Report i FNK-së mbi zbatimin e Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë nga ShKÇAK	58
Raportet nga Komisionet	67
Raport nga Komisioni për Nominime	68
Raport nga Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë	70
Raport nga Komisioni për Edukim Profesional	72
Raport nga Nënkomisioni për Tatime	74
Raport nga Komisioni për Sigurim të Cilësisë	76
Raport nga Komisioni për Standarde Profesionale	78
Statistikat e vitit 2017	80
Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur	87

STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHKÇAK-SË



TË NJOHUR NDËRKOMBËTARISHT



ShKÇAK e vendosë Kosovën në fokus të zhvillimeve globale

ShKÇAK mbetet e përkushtuar që të ofrojë kualifikime për anëtarët e saj, për t'i përmbushur nevojat e profesionistëve për ngritje profesionale dhe nevojat e tregut bashkëkohor që vazhdimisht avancohen. Shoqata përkujdeset që anëtarët e saj t'u përmbahen standardeve më të larta, gjë që ka rezultuar me kontabilistë dhe auditorë me etikë të lartë profesionale, dhe të kërkuar e me reputacion si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik në Kosovë.

Si prijës të zhvillimit të profesionit në vend dhe në rajon, misioni ynë është që të zhvillojmë dhe avancojmë një organizatë profesionale dhe konkurruese edhe në tregun ndërkombëtar dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me rritjen në numra, por në rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Vizioni ynë është që reputacioni i ShKÇAK-së në vend dhe në botë, qëndrimet tona, kontributi dhe gjurmët tona në zhvillimet globale të na bëjnë të shihemi si organizatë me ndikim nga qeveria, rregullatorët, punëdhënësit, organizatat e edukimit dhe organizmat ndërkombëtarë. Gjatë historisë sonë, me fokusin tonë për të sjellë ndryshime, ne e kemi dëshmuar këtë në të gjitha zhvillimet relevante që kanë të bëjnë me profesionin në Kosovë, e nëpër vite, ne e kemi zgjeruar fushëveprimin tonë për ta theksuar pozitën e profesionit edhe në zhvillimet globale.

Ekspertiza, përvoja dhe kontributi i anëtarëve janë qenësore për ta mbajtur ShKÇAK-në një aktor të rëndësishëm të historisë së zhvillimit të profesionit dhe ndërtimit të së ardhmes së Kosovës dhe integritetit të saj në Bashkimin Evropian (BE) dhe organizatat tjera ndërkombëtare.

Si e vetmja shoqatë profesionale nga Kosova që është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) dhe Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM), ShKÇAK është në pozitën e duhur për ta bërë Kosovën pjesë të zhvillimeve globale të profesionit. Përfaqësues të Shoqatës janë bërë pjesë e Komisionit të FNK-së për Zhvillim të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit (PAODC) si dhe pjesë e Grupit të Ekspertëve për Kontabilitet të EFAA-së, gjë që ka mundësuar që profesionistët kosovarë ta kenë zërin e tyre në këto organizatave. Në këtë mënyrë, Shoqata ka ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e politikave të këtyre organizatave globale standard-vënëse, duke shërbyer si një urë lidhëse përmes të cilës profesionistët në Kosovë mund të njihen me ato zhvillime dhe në anën tjetër, ka bërë që mjedisi dhe sfidat e profesionit në Kosovë të shqyrtohen nga standard-vënësit globalë.

Reformues në
përmbushje të
standardeve
profesionale

Fjala e Kryetarit

Të nderuar anëtarë,

Ka qenë kënaqësi t'i mirëpresim të gjithë studentët dhe anëtarët e rinj gjatë vitit 2017. T'i shohësh të rinjtë që po e shfrytëzojnë mundësinë të shkëlqejnë në profesion bashkë me ne, më mbushë me shpresa për të ardhmen. Ne jemi këtu për të krijuar kontabilistë dhe auditorë profesionistë të rinj që i duhen Kosovës, duke i ofruar kështu vendit vlera përmes anëtarëve të kualifikuar sipas standardeve ndërkombëtare, njëjtë si kolegët e tyre në vendet e zhvilluara. Në anën tjetër, kjo do të thotë që tregu i punës dhe publiku mund të besojë në aftësitë profesionale dhe etikën e kontabilistëve dhe auditorëve të çertifikuar në ShKÇAK, kudo që punojnë ata, në sektorin privat apo publik, në Kosovë dhe jashtë saj.

Si përfaqësues i një shoqate të profesionistëve me etikë të lartë, kam pasur nderin t'i përfaqësoj interesat e tyre në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilitetit (FNK), Federatën Evropiane të Kontabilitetit për NVM (EFAA) dhe Federatën Mesdhetare të Kontabilitetit (FCM) dhe ngjarjet tjera ndërkombëtare e vendore të rëndësishme për zhvillimin e profesionit. Si anëtar i Grupit të Ekspertëve të Kontabilitetit të EFAA-së kam pasur rastin t'i shoh për së afërmi mundësitë dhe sfidat e kolegëve tanë evropianë dhe të kontribuoj në zhvillimin e zgjidhjeve për ato sfida. Temat e diskutuara në organizatat globale si digjitalizimi i profesionit, ndikimi i Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar në zhvillimin e NVM-ve, presioni në profesionistët, harmonizimi me Direktivat e BE-së, mundësitë për zhvillimin e organizatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, etj., janë po aq të rëndësishme dhe aktuale

edhe në Kosovë. Për më shumë, synimi i vendit tonë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian na bën neve si profesionistë të kemi edhe më shumë përgjegjësi, duke e pasur parasysh që rregullimi i profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë duhet të zhvillohet krahas harmonizimit të tij me legjislacionin e BE-së.

Luftimi i korrupsionit tashmë është pjesë e diskutit publik të përditshëm në Kosovë dhe faktor i rëndësishëm por edhe kusht i Kosovës për tërheqjen e investimeve të huaja dhe anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare që do të çonin vendin përpara drejt një zhvillimi ekonomik dhe mirëqenies sociale. Programi për Ekspertë të Forenzikës Financiare është një përgjigje efektive e Shoqatës në favor të luftës kundër korrupsionit dhe në shërbim të interesit publik. Aftësitë e ekspertëve të forenzikës financiare mund të përdoren në hetimet më të mëdha qeveritare dhe luajnë rol të rëndësishëm në gjurmimin e rrjedhave komplekse të parave, por poashtu edhe në kontestet civile. Kudo në botë, roli i ekspertëve të forenzikës financiare çmohet shumë nga prokuroria, policia, organet rregullatore të qeverisë, avokatët, bankat, gjykatat dhe komuniteti i biznesit. Suksesi në forenzikën financiare kërkon një bagazh të njohurive, përtej asaj që konsiderohet si roli tradicional i kontabilitetit, prandaj programi Ekspert i Forenzikës Financiare është një program i rëndësishëm për të gjithë ata që dëshirojnë të avancohen në këtë fushë.

Zhvillimi i profesionit kërkon punë të vazhdueshme. Në vitin 2018 na presin sfida të reja në nivel vendor dhe atë global. Ne jemi të gatshëm t'u përgjigjemi nevojave të mjedisit profesional dhe nevojave të zhvillimit të vendit me programe specializuese. Viti 2018 besoj që mund të themi se ka filluar mbarë për sa i takon profesionit të kontabilitetit dhe auditimit.

Është miratuar Ligji i ri për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, i cili ka fuqizuar rolin e auditorit duke ia shtuar edhe një shërbim të ri: shërbimin e pajtueshmërisë, që do të jetë një funksion shtesë për ta, por edhe paraqet diversifikim edhe më të gjerë të shërbimeve të auditimit. Ky ligj po ashtu fuqizon për herë të parë edhe rolin e kontabilistit të çertifikuar, duke i dhënë përgjegjësinë e nënshkrimit të pasqyrave financiare, dhe rrjedhimisht duke ia shtuar vlerën si profesion dhe si thirrje. Jam krenar që kam qenë njëri nga promotorët më të zëshëm të kësaj pjese të Ligjit në lidhje me kontabilistët e çertifikuar. Me fuqizimin e rolit të kontabilistit të çertifikuar, do të shtohen përgjegjësitë e profesionit në lidhje me cilësinë e përgatitjes së pasqyrave financiare, e cila deri më tani ka qenë përgjegjësi e vetme për auditorët.

Shoqata duhet të reagojë ndaj këtyre ndryshimeve ligjore me kohë dhe në mënyrë të përgjegjshme. Në bashkëpunim me KKRF-në ne duhet ta shpiejmë më tutje rregullimin e profesionit të kontabilistit me akte nën-ligjore, duke i ndërlidhur kompetencat dhe përgjegjësitë e reja të këtij profesioni me nevojën për të qenë anëtar aktiv i Shoqatës, për të qenë i informuar vazhdimisht me të rejat e profesionit dhe për t'u siguruar se klientit i ofrohet niveli më i lartë i shërbimit. Prandaj, kontabilisti i çertifikuar duhet të jetë medoemos anëtar i Shoqatës, duhet të jetë pjesë e programeve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, por edhe pjesë e sistemit të kontrollit të cilësisë, si një kompetencë ekskluzive e Shoqatës.

Shoqata po ashtu duhet të mobilizohet për riaktivizimin e një armate të tërë të studentëve të saj të cilët janë të regjistruar në programin e çertifikimit, por asnjëherë nuk kanë arritur deri në cakun e tyre të fundit. Përmes një aktiviteti të organizuar dhe të sinkronizuar, ne duhet të

punojmë në vetëdijësimin e këtyre studentëve/anëtarë të ardhshëm të Shoqatës, të cilët për arsye të ndryshme kanë mbetur rrugës në procesin e certifikimit, për nevojën e domosdoshme që ata të riaktivizohen, ta fitojnë statusin e tyre profesional në të mirë të prosperitetit të tyre, në të mirë të përmirësimit të sistemit të raportimit financiar, në të mirë të shërbimit ndaj klientëve, por edhe për shkak të kërkesave të reja ligjore. Shoqata urgjentisht duhet ta hartojë një strategji se si duhet t'i qaset kësaj problematike duke pasur parasysh edhe faktin se tani jemi në kushte të konkurrencës në treg.

Unë e kam pasur nderin që të jem Kryetar i një Këshilli në të cilin shumica e anëtarëve kanë qenë femra. Mund t'ju them se kjo ka qenë një përbërje shumë efektive dhe kemi kryer shumë punë që kanë qenë në kuadër të kompetencave tona. Për mua, ka qenë një kënaqësi që kam pasur mundësinë të bashkëpunoj me anëtarët e kësaj përbërje të Këshillit. Kjo praktikë e promovimit të barazisë gjinore duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Shoqata duhet të vazhdojë të jetë vend i mundësive të barabarta për të gjithë. Në këtë frymë, përkushtimi i anëtarëve për një profesion me etikë të lartë, më jep bindjen se sfidat e profesionit do t'i kalojmë me sukses. I inkurajoj të gjithë anëtarët që të vazhdojnë me këtë përkushtim edhe në të ardhmen. Kësaj i shton vlerë edhe fillimi i zbatimit të planit të kontrollit të cilësisë gjatë vitit 2017, rezultatet e të cilit do të na japin perspektiva të reja për ta lehtësuar zhvillimin e profesionit.

Nazmi Pllana
Kryetar i Këshillit



Nga e majta lart: Fahri Breznica, Arbresha Tuhina, Nazmi Pllana, Besa Berisha, Lindita Matoshi, Burim Zagragja, Mungon Afërdita Çarkaxhiu

Të dedikuar
për mbrojtjen e
interesit publik

Mesazh nga Drejtoresha Ekzekutive

Të nderuar anëtarë,

Ngritja dhe zhvillimi i një organizate profesionale në një shtet në tranzicion nuk është aspak e lehtë, pasi që agjendat politike janë të fokusuara në shumë drejtime në të njëjtën kohë. Prandaj zhvillimit të profesioneve në përgjithësi dhe jo vetëm atij të kontabilitetit dhe auditimit nuk i është kushtuar vëmendje e duhur. Mund të jenë një mori faktorësh për këtë, siç janë ndryshimet e shpeshta të qeverive, mungesa e interesit të politikëbërësve për çështjen e raportimit financiar, mungesa e njohurive në zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe kërkesave nga direktivat relevante të Bashkimit Evropian.

Mesazhin tim po e filloj me këtë problematikë pasi që ende jemi duke u ballafaquar me mosimplementim të mirëfilltë të Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Edhe pas 19 viteve të shtet-ndërtimit, vendi ynë nuk ka arritur ta funksionalizoi në tërësi organin kryesor mbikëqyrës të raportimit financiar dhe auditimit – Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar. Qeverive të Kosovës, deri më tani, u janë dashur tre ligje për të mos lëvizur as edhe një hap drejt mbikëqyrjes së duhur të raportimit financiar, sistemit të kontrollit të cilësisë si dhe atyre shoqatave që kanë licencuar deri më tani. Për derisa vendet e zhvilluara diskutojnë sfidat e vetë-qëndrueshmërisë financiare të organizatave profesionale si rezultat i kërkesave të shtuara nga standard-vënësist, gjetjen e zgjidhjeve alternative siç është shkrirja e dy e më shumë organizatave në një, në Kosovë ballafaqohemi me hapje të shoqatave profesionale pa asnjë kriter duke rrezikuar kështu zhvillimin e një profesioni të besueshëm që duhet t'i shërbejë interesit publik dhe jo interesave personale.



Është evidente se me resurset njerëzore dhe financiare që posedon, KKRF e ka të pamundur të përmbushë misionin e tij siç kërkohet me ligj. Neglizhenca e politikëbërësve për të ngritur dhe zhvilluar këtë institucion ka bërë që raportimi financiar, mbikëqyrja e auditimit dhe zbatimi i standardeve të mos jetë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e BE-së dhe standard-vënësve ndërkombëtarë.

Besimi në profesion do të rritet vetëm kur të ketë një mbikëqyrje të mirëfilltë që do ta garantojë zbatimin e standardeve profesionale dhe të etikës si parakusht për zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme që siguron krijimin e ambientit konkurrues dhe transparent të të bërit biznes.

Shoqata jonë, si organizatë profesionale, nuk ka humbur kohë duke qëndruar duarkryq, por megjithatë ka vazhduar ta promovojë dhe zhvillojë edhe më tutje pozicionin e saj jo vetëm brenda vendit por edhe në skenën ndërkombëtare.

Shoqata këtë vit ka ndërmarrë iniciativën të bëjë një hulumtim mbi përgatitjen e pasqyrave financiare dhe auditimin e tyre. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte ngritja e vetëdijes si për përpiluesit e pasqyrave dhe auditorët, gjithashtu edhe për organet rregullatore. Nga rezultatet e hulumtimit është paraqitur nevoja për zbatim të menjëhershëm të mbikëqyrjes nga autoritetet relevante si të përpiluesve të pasqyrave financiare ashtu edhe të vetë auditorëve.

U zhvilluan programe të specializuara për të ndihmuar anëtarët tanë të jenë liderë në punën që bëjnë, duke shtuar në portfolion e tyre edhe certifikimet e veçanta siç janë Eksperti i Forenzikës Financiare, Eksperti Tatimor dhe Auditori i Brendshëm.

Por fokusi kryesor i Shoqatës në këtë vit ishte cilësia e punës së anëtarit të saj. Shoqata është duke punuar intenzivisht me anëtarët që përmes ekspertizës dhe etikës së lartë të tyre të rrisin besueshmërinë e raportimit financiar në Kosovë.

Anëtarë të nderuar, puna juaj na bën krenarë për atë që jemi sot. Vetëm ju, përmes punës tuaj, mund të dëshmoni se raportimi i mirëfilltë financiar është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që zëri ynë të dëgjohet në mënyrë që politika ta mbështesë fuqishëm zhvillimin dhe avancimin e këtij profesioni për të garantuar transparencë të duhur financiare.

Në fund dua të ju falënderoj secilin prej jush për kontributin e dhënë në Shoqatë si dhe një falënderim i veçantë për stafin e Zyrës Ekzekutive për punën e palodhshme dhe profesionale.

Ardiana Bunjaku
Drejtoreshë Ekzekutive

ZYRA EKZEKUTIVE



Nga e majta lart: Lulzim Zeka, Art Navakazi, Ardiana Bunjaku, Arbër Hoti, Edona Perjuci-Uka, Kreshnik Vokshi, Visar Krusha, Teuta Karameta, Ermal Kozgori, Burim Ahmeti, Lendita Shahini, Rina Sejdiu, Dafina Osmani, Liridona Sopa, Burbuqe Gjonbalaj, Mungon Torvioll Ukëhaxhaj

Vit i zgjerimit të kualifikimeve dhe ndikimit në zhvillimet vendore dhe ndërkombëtare

Aktivitetet tona në vitin 2017 i reflektojnë fuqishëm vlerat tona si llogaridhënia, diversiteti, integriteti, inovacionet dhe mundësitë për profesionistët, të gjitha këto në shërbim të interesit publik. Përmbushja e objektivave tona për të dhënë vazhdimisht mundësi për profesionistët dhe zhvillimin e profesionit tregojnë që ne jemi të parët në parashikimin e ndryshimeve dhe në ofrimin e mundësive kundrejt këtyre ndryshimeve, gjë që është vlerësuar nga studentët, anëtarët dhe akterët relevantë.

Si pjesë e punës së vazhdueshme vitale, gjatë këtij viti është lansuar programi Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare dhe ka filluar zbatimin e programit Auditor i Brendshëm i Çertifikuar në sektorin privat dhe publik, si dhe janë zhvilluar planprogrami dhe materialet për dy nivele të programit çertifikues Ekspert Tatimor dhe Ekspert i Lartë Tatimor, të cilat do të fillojnë të implementohen prej vitit 2018. Të gjitha këto këto programe po ofrohen për herë të parë në Kosovë bazuar në standardet ndërkombëtare, duke përmbushur kështu objektivën e paraparë në Strategjinë e ShKÇAK-së për vitet 2015-2019 në ofrimin e trajnimeve të specializuara.

Shoqata i ka përfaqësuar me shumë përkushtim interesat dhe shqetësimet e anëtarëve të saj në institucionet vendore dhe ndërkombëtare duke ngritur zërin e saj përmes komentitmit të projektligjeve, akteve nënligjore, standardeve, udhëzuesve dhe dokumenteve tjera relevante për profesionin.

Duke u thirrur në reputacionin e saj, por edhe gjithashtu duke qenë prijëse në zhvillimin e çertifikimeve në sektorin publik si në vend ashtu edhe globalisht, ShKÇAK e ka inicuar koordinimin e donatorëve për një zbatim më të

mirë të SRMFP-së, me fokus të veçantë në ngritjen e kapaciteteve, gjë që u mirëprit nga përfaqësuesit e donatorëve dhe akterëve relevantë të vendit pasi deri tani nuk ka pasur asnjë iniciativë nga organizatat vendore për këtë qëllim. ShKÇAK do të vazhdojë të shtyjë misionin e saj duke ndërmarrë iniciativa të tilla për t'i shërbyer interesit publik në të gjitha sferat e zhvillimit të profesionit.

ShKÇAK gjithashtu shënoi vit të suksesshëm, përsëri duke u thirrur në reputacionin e saj, kur Paneli për Pajtueshmëri i FNK-së i ftoi përfaqësuesit e ShKÇAK-së ta bëjnë prezantimin e punës së tyre duke filluar nga historiku i zhvillimit të ShKÇAK-së, qeverisja dhe struktura organizative, sfidat dhe mundësitë me të cilat përballet Shoqata si dhe angazhimin e saj në sektorët e ndryshëm. FNK, punën dhe zhvillimin e ShKÇAK-së e posaçërisht zhvillimin e çertifikimeve të specializuara brenda një organizate profesionale e ka marrë si shembull të mirë. FNK në vitet e fundit e ka vënë si strategji të saj për të promovuar një sistem të tillë, i cili i ndihmon organizatat profesionale të kenë vetëqëndrueshmëri financiare. Për këtë qëllim, për zhvillimet e ShKÇAK-së është kërkuar të bëhet prezantim i detajuar edhe në Mbledhjen e Asamblesë së FNK-së. Tanimë, mund të themi se ShKÇAK është një praktikë e re jo vetëm për vendet në zhvillim por edhe për vendet e zhvilluara.

Programet e çertifikimit të ShKÇAK-së në Studimin e Krahueshmërisë së Edukimit për Kontabilitet dhe Auditim të Qendrës për Reforma në Raportimin Financiar (QRRF), të Bankës Botërore, tregojnë nivel të lartë të pajtueshmërisë me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit.

Një dokument i rëndësishëm për Shoqatën në arenën ndërkombëtare gjatë këtij viti ishte publikimi i raportit të FNK-së "Dashboard Report", raport ky i cili e tregon përmbushjen e Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) në nivel të shoqatave profesionale dhe në nivel shtetëror, ku shihet se DOA-të të cilat janë në përgjegjësi të drejtëpërdrejtë të ShKÇAK-së janë të përmbushura në nivel të lartë ndërsa ato të cilat janë në përgjegjësinë të nivelit shtetëror, në këtë rast rregullatorit, janë pjesërisht të përmbushura.

Duke i marrë parasysh të gjitha zhvillimet globale si dhe kërkesat për një kornizë ligjore të mirëfilltë, kontributi i Shoqatës është fokusuar në avancimin e ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim konform standardeve ndërkombëtare, direktivave të BE-së dhe praktikave më të mira në mënyrë që ky ligj të ofrojë perspektiva për një mjedis të frytshëm për zhvillimin e profesionit, profesionistëve dhe të ekonomisë në Kosovë.

Mjedisi ku punojnë anëtarët tanë është duke ndryshuar vazhdimisht. Shpejtësia dhe vëllimi i ndryshimeve në zhvillimet globale po paraqet kërkesa të reja për kontabilistët dhe auditorët, duke krijuar sfida, por edhe mundësi të reja. Në këtë drejtim, ShKÇAK ka punuar në avancimin e komunikimit intensiv me anëtarët për të gjetur forma më të përshtatshme për adresimin e të gjitha çështjeve, por gjithashtu edhe për promovimin e punë së tyre përmes uebfaqes dhe forumit online. ShKÇAK është e përkushtuar t'i përmbushë të gjitha kërkesat dhe të vë anëtarin e saj në hartën globale.



Ceremonia e ndarjes së çertifikateve

Edukimi shtyllë e rëndësishme në përmbushje të objektivave zhvillimore të vendit

Zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi i infrastrukturës ligjore janë ndër shtyllat kryesore të zhvillimit të vendit dhe rrugë për integrimin e tij në BE dhe organizata tjera ndërkombëtare. Zhvillimi i profesionit të kontabilitetit dhe auditimit luan rol të rëndësishëm në ndërtimin e këtyre shtyllave.

Zgjerimi i kualifikimeve konform nevojave të profesionit në Kosovë, harmonizimi i vazhdueshëm i programeve të edukimit me standardet ndërkombëtare të edukimit dhe integrimi me zhvillimet globale janë objektiva që ShKÇAK i mban në fokus të vazhdueshëm. Në këtë mënyrë, ShKÇAK me shumë përgjegjësi e bartë një rol të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave zhvillimore të vendit.

Përmes programeve gjithëpërfshirëse dhe të standardit të lartë, ShKÇAK iu ofron anëtarëve të saj një varg mundësish në profesion për plotësimin e nevojave të tregut dhe ekonomisë në Kosovë. Gama e gjerë e kualifikimeve ekzistuese në sektorin privat dhe publik vazhdon të jetë shumë e kërkuar nga profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit.

Me qëllim të ofrimit të specializimeve që mbulojnë të gjitha sferat e profesionit dhe duke qenë se roli i ekspertit tatimor në një organizatë private apo publike është të ofrojë këshilla lidhur me aplikimin sa më të drejtë dhe efikas të legjislacionit tatimor, Shoqata ka konsideruar se çertifikimi i njohurive dhe aftësive profesionale për një profesion të tillë kaq të rëndësishëm është shumë i domosdoshëm. Prandaj qëllimi kryesor i çertifikimit në lëminë e tatimeve është që të gjithë të interesuarit të pajisen me njohuri teorike dhe praktike të specializuara vetëm në fushën e tatimeve në mënyrë që këshillat dhe puna e ekspertëve të

tillë të jetë sa më dobiprurëse për organizatat ku ata janë të punësuar, apo të cilave u ofrojnë shërbime. Për të realizuar këtë, gjatë këtij viti janë zhvilluar planprogrami dhe materialet për dy nivele të programit çertifikues Ekspert Tatimor dhe Ekspert i Lartë Tatimor, të cilat do të fillojnë të implementohen prej vitit 2018.

Programet e çertifikimit të ShKÇAK-së si në sektorin privat, poashtu edhe në atë publik, duke përfshirë edhe auditimin e brendshëm, edhe këtë vit kanë tërhequr interesim të madh nga gjeneratat e reja, por gjithashtu edhe nga bizneset.



<http://forum.scaak.org/>

Azhurnimi i programeve çertifikuese si dhe kërkesa e shtuar për këto programe kanë bërë që ShKÇAK të investojë në ngritjen e kapaciteteve të reja. Ky investim, i cili është më se i domosdoshëm, është bërë për të arritur rezultate më të mira dhe për ta ngritur performancën jo vetëm të ligjëruesve por edhe t'u ndihmojë kandidatëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi për ngritjen profesionale të tyre. Shoqata, në vazhdimësi organizon Trajnim të Trajnerëve dhe takime me ligjëruesit në mënyrë që të përmbushen këto objektiva.

Ekspertët e Licencuar të Forenzikës Financiare faktorë të rëndësishëm në luftimin e korrupsionit

Megjithë përkushtimin e shprehur të autoriteteve për ta luftuar korrupsionin, ai vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore në rrugën drejt zhvillimit ekonomik të Kosovës. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve të vendit në identifikimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimeve financiare është faktor më së i rëndësishëm. Për të arritur ngritjen e kapaciteteve për ta luftuar këtë dukuri, ShKÇAK me mbështetjen e UNDP-së dhe financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (Swiss Cooperation Office) dhe Programi DANIDA i Qeverisë së Danimarkës, ka zhvilluar programin çertifikues Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare.

Ky program ka për qëllim sigurimin e ekspertëve të licencuar duke i pajisur ata me njohuri, aftësi dhe ekspertizën e duhur që rezultojnë të jenë thelbësore për luftimin e korrupsionit si parakusht për zhvillimin e ekonomisë në Kosovë. Programi, fillimisht i përfshinë institucionet kryesore të Kosovës përgjegjëse për luftimin e korrupsionit si: Prokuroria, Policia, Administrata Tatimore, Dogana, Njësia e Inteligjencës Financiare, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe gazetarët investigativë të BIRN-it, por gjithashtu ky program do t'iu ofrohet edhe anëtarëve të ShKÇAK-së dhe publikut të gjerë.

Në të njejtën kohë, Shoqata i ka përgatitur planprogramet dhe pakot me dokumentacionin dhe materialet e duhura për këtë program dhe për programin për ekspertë tatimorë dhe i ka dorëzuar ato për akreditim në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.



Lansimi i programit Ekspert i Licencuar i Forenzikës

Mundësi të reja për anëtarët e ShKÇAK-së në arenën ndërkombëtare

Si shtet i ri, Kosova përballlet me barriera të ndryshme për njohje si në arenën politike, ekonomike e gjithashtu edhe në atë të edukimit. ShKÇAK dëshmon edhe një herë që me punë dhe përkushtim, e posaçërisht me cilësi të lartë të zhvillimit, arrinë edhe një njohje të radhës. Zgjerimi i njohjeve reciproke me shoqatat profesionale globale është një pikë e rëndësishme strategjike e Shoqatës, që iu mundëson anëtarëve rritje të mundësive për punë edhe jashtë Kosovës.

Shoqata deri më tani ka njohje reciproke me Institutin e Licencuar për Financa Publike dhe Kontabilitet dhe Auditim në Britani të Madhe (CIPFA), ku gjatë vitit 2017, 32 anëtarë kanë përfituar anëtarësi të dyfishtë në këto dy organizata prestigjioze. ShKÇAK ka vazhduar me azhurnimin e kurrikulës së saj dhe si rrjedhojë është akredituar edhe për lëndën Menaxhimi i Performancës nga Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar të Britanisë së Madhe (ACCA). Tanimë, ShKÇAK është akredituar për të gjitha lëndët e nivelit themelor (ACCA Fundamentals).

Gjithashtu, njohjeve reciproke i është shtuar edhe një organizatë profesionale, Shoqata e Teknikëve të Kontabilitetit nga Britania e Madhe (AAT), që i ka në vete rreth 140 mijë anëtarë në më shumë se 90 vende të botës. Me këtë anëtarëve iu është ofruar edhe një mundësi për t'i ofruar shërbimet e tyre në tregun ndërkombëtar të punës.



Association of
Accounting Technicians



Association of Chartered
Certified Accountants



Chartered Institute of Public
Finance and Accountancy

Spektër i gjerë i temave në Edukimin e Vazhdueshëm Profesional për ngritje të cilësisë së raportimit financiar dhe auditimit

Anëtarët e ShKÇAK-së duhet që të ofrojnë shërbime efektive dhe të cilësisë së lartë për punëdhënësit dhe klientët e tyre. Është e rëndësishme që ata gjithmonë të jenë të informuar dhe në hap me zhvillimet profesionale. Mbajtja e kompetencave teknike bën që profesionistët krahas punës së besueshme që ata ofrojnë, të mësojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre gjatë gjithë karrierës. Shoqata përmes sesioneve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional ndihmon anëtarët që t'i arrijnë këto qëllime.

Këtë vit me kërkesë të anëtarëve dhe gjithashtu duke u bazuar edhe në zhvillimet e fundit të ligjeve dhe standardeve, Shoqata ka realizuar planin e EVP-së duke ofruar temat si në vijim: Lizingu (SNK 17, SNRF 16), Të hyrat (SNK 18, SNRF 15), Ngarkesa e kundërt e ndërtimtarisë – shembuj praktik, Standardet e opinionit të auditorit (ndryshimet e fundit me raste konkrete studimore, SNA 700, 701, 705, 706), SNK 38 Pasuritë e Patrupëzuara, SNK 40 Investimi në Pasuri të Patundshme, SNRF 5 Pasuritë joqarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera, Vlerësimi i rrezikut dhe reagimi i auditorit ndaj rreziqeve të vlerësuara, Standardi për angazhimin e rishikimit (ISRE 2400 i rishikuar), Zbatimi në praktikë i procedurave analitike të auditimit si dhe sesioni i EVP-së, që u mbajt në bashkëpunim me Deloitte Kosova për SNRF 9.

Gjatë këtij viti, për herë të parë Shoqata ka filluar me implementimin e sesioneve të EVP-ve të bazuara në rezultate (output). Plotësimi i kërkesës për EVP të bazuara në rezultate (output) bën që ShKÇAK të plotësojë në tërësi kërkesat e SNE 7. Nga ky sistem i vlerësimit përfitojnë gjithashtu edhe anëtarët e Shoqatës meqenëse njohuritë e fituara gjatë EVP-së janë të matshme në fund të trajnimit.



Zbatimi i sigurimit të cilësisë për ngritje të kredibilitetit të anëtarëve

Roli i sigurimit të cilësisë është një nga pikat kryesore strategjike dhe të rëndësishme të ShKÇAK-së. Padyshim, ky funksion ka për qëllim ngritjen e cilësisë së raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë dhe ngritjen e besueshmërisë së investitorëve, kreditorëve dhe shfrytëzuesve të tjerë të informatave financiare.

Bazuar në nenin 15, pika 1.5 e Ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, KKRF është autoriteti kompetent përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurimit të cilësisë së auditorëve të licencuar dhe firmave të licencuara të auditimit. Edhe pse sipas legjislacionit në fuqi, ShKÇAK ka përgjegjësi të kufizuar për sistemin e sigurimit të cilësisë, ajo vazhdon të mbetet e vetmja që ka ndër-marrë hapa konkrete në këtë fushë.

Bazuar në rregullorën e sigurimit të cilësisë të ShKÇAK-së, secili auditor ligjor, anëtar i ShKÇAK-së, do t'i nënshtrohet kontrollit të cilësisë, së paku një herë në tre vite. Gjatë ciklit të parë të kontrollit të cilësisë, ShKÇAK ka mbajtur takime me 15 auditorë ligjorë dhe ka rishikuar 30 raporte të auditimit.

Vizitat e auditorëve ligjorë kishin për qëllim:

Rishikimin dhe diskutimin në lidhje me implementimin e Doracakut të Sistemit për Kontrollin e Cilësisë, në lidhje me

- ekzistencën e doracakut;
- përshtatjen me situatat specifike të firmës;
- trajnimin dhe komunikimin;
- pranimin e klientëve dhe vazhdimësinë;
- politikat e monitorimit të letrave të punës.

Rishikimin dhe diskutimin sa i përket angazhimeve të auditimit (dosjes së auditimit), për të parë zbatueshmërinë e SNA-ve dhe Kodit të Etikës, lidhur me:

- pranimin e klientit dhe vazhdimësinë;
- planifikimin e materialitetit;
- vlerësimin e rrezikut të kombinuar;
- qasjen e auditimit;
- konkluzionet e auditimit;
- opinionin e lëshuar;
- komunikimin me klientin.

Pas përfundimit të vizitave, secilit auditor i është dërguar raporti individual i kontrollit, ku përveç të gjeturave, janë dhënë edhe rekomandimet për përmirësim të cilësisë. Auditorët janë përgjigjur pozitivisht ndaj të gjeturave të identifikuara dhe rekomandimeve të dhëna. Ata janë zotuar që do të marrin veprime adekuate për ta përmirësuar cilësinë e auditimit.

Gjithashtu, të gjeturat e prezantuara në këto raporte të kontrollit kanë shërbyer si bazë në përcaktimin e temave të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), që ka rezultuar të jetë një mënyrë mjaft e mirë e ndërveprimit të këtyre dy proceseve, kontrollit të cilësisë dhe edukimit të anëtarëve të ShKÇAK-së.

Në të njëjtën kohë, Shoqata është takuar me zyrtarët e QRRF-së së Bankës Botërore për të diskutuar mbi pikëpamjet e ShKÇAK-së mbi sistemin e sigurimit të cilësisë në Kosovë, para fillimit të projektit të ri të KKRF-së mbështetur nga QRRF e Bankës Botërore që ka për qëllim zhvillimin e KKRF-së me elementet dhe mjetet kyçe për një sistem të qëndrueshëm të mbikëqyrjes dhe të sigurimit të cilësisë së auditimit në Kosovë.



Avancimi i shërbimit dhe komunikimit me anëtarë

ShKÇAK është e përkushtuar të gjejë forma të reja të komunikimit me anëtarët në mënyrë që kërkesat dhe nevojat e tyre për zhvillim profesional të adresohen. Gjithashtu, që përvoja dhe ekspertiza e tyre të kenë profil sa më të lartë në publik. Shoqata këtë e ka realizuar përmes seminareve, tryezave të rrumbullakëta dhe konferencave me qëllim që të iniciohen tema për diskutim në mes të anëtarëve dhe palëve tjera të interesit.

Meqë anëtarët e Shoqatës janë të kërkuar në treg, ShKÇAK ka ridizajnuar uebfaqen në mënyrë që palët e interesuara mund t'i referohen uebfaqes së ShKÇAK-së për të marrë informata për anëtarët dhe shërbimet që ata i ofrojnë. Për këtë qëllim uebfaqja e ridizajnuar i përmbanë profilet e të gjithë anëtarëve.

Në mënyrë që ShKÇAK të jetë adresa për diskutimin e temave që kanë të bëjnë me profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, është zhvilluar forumi online si platformë e re në uebfaqen e ShKÇAK-së. Ky forum iu ofron anëtarëve mundësi të diskutojnë për tema relevante për profesionin. Ne mbesim me qëndrimin që në një mjedis profesional vazhdimisht të ndryshueshëm që rrjedhimisht po paraqet kërkesa dhe sfida për kontabilistët dhe auditorët, përfshirja e profesionistëve dhe palëve me interes në debatin për zhvillimin e profesionit dhe zhvillimin ekonomik në vend, është një përgjegjësi e pashmangshme e secilit. Ne jemi të përkushtuar në ofrimin e informatave dhe mundësive të reja konform ndryshimeve të kohës.



Punëtorja me Këshill dhe Komisione, Prevallë

Shoqata i fton të gjithë anëtarët e saj dhe palët e interesit që të bëhen pjesë e këtij forumi dhe ta shfrytëzojnë atë si një mjet i mirë i debatit për tema të ndryshme, për çështje që i hasin në përditshmërinë e tyre profesionale dhe për t'i dhënë opinionet e tyre mbi aspekte të ndryshme të zhvillimit të profesionit në vend dhe në botë.

Tregu i punës në Kosovë për profesionin e kontabilistëve dhe auditorëve është parë që nuk është edhe aq i favorshëm dhe në këtë drejtim Shoqata ka filluar grumbullimin e informatave nga anëtarët për t'i identifikuar problemet me të cilat ata ballafaqohen gjatë punës së tyre si në aspektin e legjislacionit, në rritjen e biznesit të tyre ashtu edhe në implementimin e standardeve ndërkombëtare që kërkohen nga ata.

Informatat e nxjerrura do të përdoren në dobi të anëtarëve duke i dërguar mesazhet dhe kërkesat e tyre tek institucionet përkatëse, duke bërë promovimin e tyre tek punëdhënësit si dhe duke i përdorur si bazë për Planin Strategjik të ShKÇAK-së.

Në vitin 2017, Këshilli i ShKÇAK-së kishte marrë vendim që Mbledhja Vjetore e Asamblesë së Përgjithshme dhe EVP-ja e radhës të mbahej jashtë Kosovës, duke marrë si shembull për një organizim të tillë nga organizatat profesionale globale, për t'u dhënë mundësi anëtarëve të jenë më të fokusuar në shkëmbimin e përvojave dhe diskutimin e çështjeve relevante. Mbledhja Vjetore u mbajt gjatë muajti maj në Pogradec. Ky organizim u cilësua lart nga anëtarët dhe u kërkua që Shoqata të bëjë organizime të tilla jashtë Kosovës edhe në të ardhmen.



Zhvillimi i sistemit të raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë

Ligji Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim edhe në vitin 2017 ishte në diskutim nga politikëbërësit dhe profesionistët. Shoqata, që nga viti 2011 kur ky ligj ka hyrë në fuqi, në vazhdimësi ka bërë përpjekje për t'i dhënë inputet në amandamentimin e Ligjit, në mënyrë që kërkesat e Ligjit të jenë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, direktivat e BE-së dhe të jetë i zbatueshëm për mjedisin biznesor dhe ekonomik në vend. Duke bashkëpunuar me të gjitha palët e përfshira dhe me ndihmën e Bankës Botërore, Shoqata në vitin 2013 kishte organizuar edhe seminarin "Rruga drejt Evropës", për t'i adresuar rekomandimet e raportit ROSC të Bankës Botërore, duke i vënë në pah edhe mangësitë e Ligjit.

Rekomandimet e dala nga ky seminar ishin: SNRF duhet të jetë korniza e raportimit financiar për të gjitha entitetet biznesore; organizatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit do të duhet domosdo të jenë anëtarë me të drejta të plota në FNK; shqyrtimi i pragjeve dhe klasifikimi i shoqërive tregtare për qëllime të raportimit financiar dhe të auditimit; implementimi i SNRF për NVM nga NVM-të në Kosovë.

Në lidhje me rolin rregullativ mbikëqyrës të KKRF-së ishin dy propozime. Propozimi i parë ishte të krijohet një bord mbikëqyrës, anëtarët e të cilit do të emërohen dhe do t'i raportojnë Parlamentit të Kosovë dhe do të jetë një bord i pavarur, si për nga financimi, ashtu edhe për nga marrja e vendimeve. Propozimi i dytë ishte krijimi i një bordi mbikëqyrës në kuadër të KKRF-së, në përbërje nga KKRF, BQK dhe ShKÇAK.

Sa i përket sigurimit të cilësisë, propozimet nga ky seminar ishin që rishikimin e auditorëve ligjorë – personave fizikë, ta kryejë ShKÇAK, ndërsa firmat të rishikohen nga KKRF; ose alternativa tjetër ishte që ShKÇAK t'i rishikojë firmat e auditimit, të cilat kryejnë auditime të ndërmarrjeve që nuk janë me interes publik, ndërsa KKRF të atyre që kryejnë auditime të ndërmarrjeve me interes publik.

Disa nga këto rekomandime, si implementimi i SNRF dhe SNRF për NVM janë zbatuar përmes udhëzimeve administrative të nxjerra nga KKRF, ndërsa të tjerat janë çështje që nuk janë adresuar deri më tani.

Për këtë arsye, Shoqata në vazhdimësi ka inicuar debate me palët e interesit si dhe ka organizuar punëtori me anëtarët e saj për t'i diskutuar plotësimet dhe ndryshimet e nevojshme të ligjit, me qëllim të eliminimit të mangësive që janë në këtë ligj.

Në këtë drejtim, në vitin 2017, Shoqata ka organizuar punëtori me anëtarët për të mbledhur komente dhe rekomandimet e dala nga kjo punëtori kanë të bëjnë me përmirësimin e kornizës së raportimit financiar të shoqërive tregtare, përmirësimin e sistemit të sigurimit të cilësisë duke përfshirë edhe komentet mbi përgjegjësitë e bordit të pavarur të mbikëqyrjes publike si dhe komente të tjera me qëllim të harmonizimit të ligjit me kërkesat e direktivave përkatëse të BE-së.

Përmbledhje e komenteve për Amandamentimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim:

- Për shkak se në Kosovë të gjitha ndërmarrjet janë ndërmarrje të vogla në krahasim me kriteret e përcaktuara nga BE, për qëllime të raportimit dhe auditimit, Shoqata ka thjeshtëzuar më tutje këto kriteret. Është propozuar ndarje e kërkesave për zbatim të standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar nga kërkesat për zbatim të standardeve të auditimit si dhe kërkesat për angazhim të auditorit dhe raportim nga auditori.
- Ndarje e qartë e detyrave për sigurimin e cilësisë ndërmjet rregullatorit dhe shoqatave profesionale. Rregullatori të jetë përgjegjës për themelimin e Komitetit të mbikëqyrjes së auditorëve ligjorë që bëjnë auditime të institucioneve me interes publik, ndërsa shoqatat profesionale të jenë përgjegjëse për kryerjen e kontrollit të cilësisë së auditorëve ligjorë, të cilët kryejnë auditime të subjekteve tjera nga ato me interes publik. Komiteti i mbikëqyrjes së auditorëve ligjorë të mbikëqyrë procesin e kontrollit të cilësisë nga shoqatat profesionale.
- Krijimi i komitetit të mbikëqyrjes së auditorëve ligjorë, në kuadër të KKRF-së dhe i cili do të ketë rolin përfundimtar në kontrollin e cilësisë së punës së auditorëve si dhe në hetimin dhe disiplinën e tyre dhe i cili do të përbëhet nga KKRF, BQK dhe Shoqatat.



Ndër komentet tjera, veçojmë: forcimi i rolit të Kontabilistit të Çertifikuar (KÇ), përmes propozimit të përkufizimit më të qartë të KÇ-së dhe përcaktimit të përgjegjësi; mbikëqyrja e organizatave profesionale të bëhet një herë në pesë vite nga një organizatë tjetër profesionale, anëtare e FNK-së, përderisa në ligjin ekzistues, mbikëqyrja kërkohet të bëhet nga një kontabilist ose organizatë.

*Ndryshimet ligjore në çdo fushë janë rezultat i ndryshimeve dhe i nevojës për azhurnime si dhe përshtatje me rrethanat e krijuara. Së këtejmi, edhe ndryshimet e propozuara në Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim në Kosovë janë konform ndryshimeve në ekonominë e vendit si dhe paraqesin përafrim të kornizës institucionale të Kosovës me *acquis communautaire* të BE-së.*

Një ligj i tillë ndihmon, në radhë të parë, në përmirësimin e mjedisit të bizneseve dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike, përmirësimin e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve vendore dhe krijimin e klimes për tërheqjen e investimeve, në rritjen e besimit në sektorin privat por gjithashtu është edhe mekanizëm që ndikon në transparencë, llogaridhënie dhe në parandalimin e informalitetit në ekonominë e vendit.



ShKÇAK kontribuese aktive në zhvillimet vendore dhe globale të profesionit

Qëndrueshmëria e ShKÇAK-së vlerësohet lart nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK)

ShKÇAK është shumë aktive jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon në promovimin e organizatave të qëndrueshme profesionale, të cilat kontribuojnë në zbatimin e standardeve në nivel të lartë, si dhe krijojnë profesionistë me etikë të lartë. Duke qenë pjesë e FNK-së për shumë vite, ShKÇAK është e obliguar t'i plotësojë kërkesat, të cilat FNK i nxjerrë për anëtarët e saj e posaçërisht implementimin e DOA-ve. Në këtë drejtim, ShKÇAK e ka parë të domosdoshme që departamentet e saj, të cilat merren me implementimin e DOA-ve të FNK-së, të bëjnë një vizitë në Zyrën Ekzekutive të FNK-së për t'u njoftuar më për së afërmi me zhvillimet dhe kërkesat e fundit. Udhëzimet dhe publikimet e FNK-së janë dëshmuar të jenë shumë të dobishme për zhvillimin e profesionit, por si shoqatë profesionale e vogël me resurse të kufizuara, Shoqata e ka të vështirë t'i ndjekë të gjitha zhvillimet globale. Përmes diskutimeve ballë për ballë me stafin dhe komisionet e FNK-së, përfaqësuesit e Shoqatës kanë përfituar njohuri të gjera mbi zbatimin e këtyre kërkesave për vendet në zhvillim.



ShKÇAK në Forumin e MOSAIC, FNK, Nju Jork

Në takimin me Departamentin për Praktika të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, ShKÇAK ka ngritur shqetësimin e saj mbi atë se Praktikantët e Vogla dhe të Mesme në Kosovë janë shumë të vogla dhe përbëhen nga një ose dy auditorë dhe si rezultat kanë vështirësi në zbatimin e kërkesave që janë gjithnjë në rritje.

Me qenë se aktualisht shoqatat profesionale të rajonit po e diskutojnë idenë e një profesioni të rregulluar për kontabilistët e certifikuar, duke e përfshirë sigurimin e cilësisë së punës së tyre, ShKÇAK e ka diskutuar edhe këtë çështje me Komisionin e Kontabilistëve në Biznes të FNK-së.

Një nga sfidat më të mëdha që po përballen shumica e shoqatave profesionale në vendet në tranzicion është përmirësimi i mjedisit rregullativ, prandaj ShKÇAK ka diskutuar me Departamentin Ligjor dhe Rregullativ se si mund të ndihmojë FNK-ja në negociata efektive me politikëbërësit si dhe rreth marrëdhënies së FNK-së me rregullatorët e vendeve në zbatimin e DOA-ve.

Për të përfituar metoda dhe mjete të reja dhe efektive për të qenë sa më afër anëtarëve të saj, ShKÇAK është takuar me Departamentin e Komunikimit të FNK-së. ShKÇAK ka vënë kontakte direkte me këtë departament në mënyrë që të gjitha zhvillimet e saj, e posaçërisht ato për specializimet e zhvilluara profesionale t'i publikojë në Global Gateway të FNK-së, prej të cilave mund të përfitojnë edhe organizatat tjera.

Duke qenë se për DOA 6 Hetimi dhe Disiplina, përgjegjësia për zbatim në Kosovë është e ndarë në mes të ShKÇAK-së dhe KKRF-së dhe ka vështirësi në implementim, Shoqata është takuar edhe me Komisionin për Etikën Profesionale, me të cilët janë diskutuar format dhe modalitetet e implementimit sa më të drejtë të Kodit të Etikës së FNK-së dhe të standardit të ri për etikën Kundërpërgjigjja mbi Mospajtueshmërinë me Ligjet dhe Rregullativat (NOCLAR).

Me Departamentin për Mbështetje Globale të Profesionit është diskutuar mbi sfidat dhe mundësitë e zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik nga qeveritë duke u bazuar në parimin aktual.



Takimi me Panelin e Pajtueshmërisë së FNK-së, Nju Jork

Përfaqësuesit e ShKÇAK-së prezantuan para Panelit për Pajtueshmërinë, i cili është përgjegjës për rishikimin e përmbushjes së kërkesave të FNK-së për anëtarët e saj.

Para anëtarëve të këtij paneli përfaqësuesit e Shoqatës prezantuan për historikun e zhvillimit të ShKÇAK-së, qeverisjen dhe strukturën organizative, arritjet e saj, sistemin e raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë, sfidat dhe mundësitë me të cilat përballlet Shoqata si dhe angazhimin e saj në sektorët e ndryshëm. Përfaqësuesit e Shoqatës u ballafaquan me pyetje prej më të ndryshmeve e posaçërisht mbi implementimin e DOA-ve në tërësi duke e theksuar se ShKÇAK, si një shoqatë e vogël dhe e re, krahasuar me shoqatat e vendeve tjera në zhvillim, ka arritur kaq shumë për një kohë të shkurtër dhe sot merret shembull nga shoqatat më me renome në botë. ShKÇAK u vlerësua lart nga paneli për iniciativën e marrë në zhvillimin e e specializimeve në fusha të ndryshme, gjë që krijon bazë për qëndrueshmëri afatgjatë.

Në fund të takimit, paneli i vlerësoi lart të arriturat e Shoqatës me ç'rast kërkoi nga përfaqësu-

esit e saj që ShKÇAK të prezantohet si shembull suksesi për të gjitha vendet e tjera në zhvillim. Me këtë vlerësim të lartë nga paneli, ShKÇAK mori ftesën nga FNK që ta prezantojë punën dhe zhvillimet e saj në Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë së FNK-së në Bruksel.

Delegacioni i ShKÇAK-së u ftua të marrë pjesë edhe në Takimin e PAODC dhe në Forumin e Donatorëve të MOSAIC, pasi që këto takime u zhvilluan në kohën kur delegacioni i Shoqatës ishte në vizitë të FNK-së.

Gjatë qëndrimit të tyre në Nju Jork, përfaqësuesit e ShKÇAK-së u pritën në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Nju Jork, ku diskutuan rreth zhvillimeve të profesionit në Kosovë dhe vizitës së tyre në FNK. Diplomatat e Konsullatës u shprehën të gatshëm ta ndihmojnë Shoqatwn me përfaqësimin e tyre në FNK si dhe e përgëzuan ShKÇAK-në për përfaqësimin e shtetit të Kosovës në organizmat ndërkombëtarë.



Vizita në Konsullatën e Republikës së Kosovës, Nju Jork

ShKÇAK merr përvojë mbi praktikat më të mira nga Instituti Amerikan i Auditorëve (AICPA), shoqata më e madhe profesionale në SHBA

Për të thelluar bashkëpunimin me organizata profesionale, ShKÇAK gjatë qëndrimit në Nju Jork, pati takime të njëpasnjëshme me AICPA, organizatë kjo e cila pranoi të bëjë monitorimin për zbatimin e standardeve dhe procedurave të përcaktuara me ligj kërkesave të dala nga FNK dhe të ligjeve vendore. Në këto takime, ShKÇAK ka diksutuar për çështjet reLevante me qëllim që të përfitojë praktika më të mira, duke qenë se AICPA është shoqata e vetme dhe me numër shumë të madh të anëtarësisë në SHBA.

ShKÇAK, si një organizatë profesionale në një vend në zhvillim e cila përballet me sfida në zbatimin e sistemit të sigurimit të cilësisë dhe sistemit të hetimit dhe disiplinës për anëtarët e saj, ka zhvilluar takim me departamentin e sigurimit të cilësisë të AICPA-së me qëllim që të merren informatat e brendshme të praktikave të tyre në këtë fushë. Përfaqësuesit e ShKÇAK-së diskutuan rreth programit të sigurimit të cilësisë që AICPA bën për afro 10,000 firma të auditimit brenda një viti si dhe modalitetet e ndihmës që mund t'i japë AICPA për zhvillimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në Kosovë.

Përfaqësuesit e ShKÇAK-së u takuan edhe me përfaqësues nga Departamenti i AICPA për Çështje Politike dhe të Kongresit, ku ky departament theksoi se për të qenë sa më afër zhvillimeve ligjore dhe për të qenë pjesë e tyre, ka një zyrë të veçantë edhe në Uashington D.C e cila është në komunikim të vazhdueshëm me kongresmenët. Gjatë këtij takimi ata morën përvoja mbi atë se si AICPA bashkëpunon me ligjvënësit dhe kërkoi nga AICPA të ndihmojë institucionet e Kosovës për të përmirësuar kornizën ligjore për zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë.

Takimet u zhvilluan edhe me drejtorët dhe menaxherët e lartë të departamenteve të shërbimit për anëtarë, shërbimit akademik dhe studentor, departamentit për çertifikimin e kontabilistëve menaxherialë, si dhe divizionit për etikën profesionale.

Avancimi i AICPA-së në teknologjinë informative ishte një ndër temat për të cilën ShKÇAK ishte mjaft e interesuar të marrë përvoja praktike. Kërkesat që AICPA i zbaton për anëtarët e saj, EVP-të, sistemi i provimeve, inovacionet dhe strategjia, ishin poashtu pika të cilat u diskutuan në detaje.

Përfaqësuesit e AICPA shprehën gatishmërinë e tyre që të ofrojnë ndihmë dhe këshilla profesionale për zhvillimin sa më të qëndrueshëm të profesionit në një shtet të ri, si dhe përgëzuan ShKÇAK-në për arritjet e tyre të mëdha si një shoqatë në një shtet në zhvillim.



Takimi në AICPA, Nju Jork

Aktivitetet e Shoqatës si anëtare në organizatat ndërkombëtare

Shoqata tashmë ka dëshmuar se është pjesë e zhvillimeve jo vetëm vendore, por edhe atyre ndërkombëtare, duke e dhënë kontributin e saj përmes komisioneve të organizatave ndërkombëtare, komentimin e standardeve si dhe udhëzuesve të tjerë që dalin nga këto organizata. Duke qenë anëtare me të drejta të plota, tanimë në tri organizata, FNK, EFAA, FCM, përfaqësuesit e Shoqatës janë aktivë me pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre gjatë takimeve vjetore të asamblesë. Me pjesëmarrjen dhe votën e saj, Shoqata kontribuon në zhvillimin e profesionit duke e faktorizuar ekspertizën dhe përvojën e anëtarëve të saj në zhvillimet globale të profesionit.

Me ftesë të FNK-së dhe pas prezantimit të suksesshëm që delegacioni i ShKÇAK-së e bëri para Panelit për Pajtuueshmëri të FNK-së, ShKÇAK-së prezantuan në Mbledhjen e Asamblesë së FNK-së në Bruksel mbi rrugëtimin e zhvillimit të ShKÇAK-së ndër vite, si një shembull i mirë i zhvillimit të një shoqate profesionale në vendet në zhvillim, prej konceptit deri në zbatim. Edhe prezantimi në Mbledhjen e Asamblesë së FNK-së u prit mjaft mirë nga të pranishmit dhe FNK, të cilët zyrtarisht përgëzuan ShKÇAK-në për punën e bërë. *"Ju falënderoj nga zemra për prezantimin e ekipit tuaj para Këshillit të FNK-së. Prezantimi u vlerësua lart nga anëtarët tanë. Me kënaqësi presim të vazhdojmë të mësojmë nga ju dhe të punojmë me ju. Ekipi dhe puna e juaj janë me të vërtetë të mrekullueshëm",* Alta Prinsloo, Drejtoreshë e Departamentit të Cilësisë dhe Zhvillimit të FNK-së.



ShKÇAK prezanton në Mbledhjen e Asamblesë së FNK-së, Bruksel

Për më shumë, si pjesë e komisioneve profesionale brenda këtyre organizatave, Shoqata është e përfshirë për së afërmi në bërjen e politikave të këtyre organizatave globale.

Megjithatë Shoqata është anëtarësuar në EFAA vetëm një vit më parë, falë angazhimit të saj arriti që brenda një periudhe shumë të shkurtër të bëhej pjesë e Grupit të Ekspertëve të Kontabilitetit dhe Auditimit të EFAA-së. Kryetari i Këshillit, Z. Nazmi Pllana, anëtar i këtij Grupi ka marrë pjesë në takimet e rregullta të këtij grupi, ku u diskutua ndikimi i SNRF-ve në zhvillimin e NVM-ve, duke e pasur parasysh faktin që shumica e rregullave dhe standardeve për kontabilitet dhe auditim në nivel të BE-së apo nivel ndërkombëtar shpesh janë të frymëzuara nga kompanitë e mëdha. Për këtë, EFAA ka përgatitur një hulumtim, ku janë shpalosur dëshmitë se sa, kohëve të fundit, kanë ndikuar standardet e kontabilitetit dhe auditimit për kompanitë e mëdha në zhvillimin e trajtimit kontabël për NVM-të, në mënyrë që ato të adresohen nga standard-vënësit.

Një temë tjetër që u diskutua nga ky grup ishte shqyrtimi i mundësive të përfitimit të organizatave anëtare të EFAA-së nga plani i Komisionit Evropian "Unioni i Tregjeve të Kapitalit".

Ky plan ka për qëllim mobilizimin e kapitalit në Evropë duke e orientuar kapitalin të gjitha kompanitë, duke përfshirë këtu edhe NVM-të, dhe të projektet e infrastrukturës që kanë nevojë për kapital për t'u zgjeruar dhe për të krijuar vende të reja të punës.

Gjatë vitit 2017, një prej temave aktuale e të gjitha konferencave të këtyre organizatave ndërkombëtare ishte digjitalizimi i profesionit të kontabilitetit dhe auditimit. Teknologjitë si blockchain, inteligjenca artificiale dhe analizimi i të dhënave po kanë ndikim të madh edhe në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, prandaj azhurnimi i njohurive të profesionistëve mbi këtë teknologji është i domosdoshëm. Digjitalizimi kohëve të fundit ka marrë hov edhe në Kosovë dhe në këtë drejtim Shoqata është duke i shqyrtuar opsionet për t'iu ofruar anëtarëve dhe publikut mundësi të reja të ngritjes profesionale për shfrytëzimin e digjitalizimit në kontabilitet dhe auditim. Në këtë kontekst, Shoqata ka marrë pjesë në studimin e EFAA-së, që do të ndihmojë në zhvillimin e strategjisë dhe planit të punës së EFAA për t'iu përgjigjur përfshirjes së digjitalizimit në profesion.



Konferenca "Kontabiliteti dhe Etika", EFAA



Konferenca vjetore e FCM-së

Si Këshilltare Teknike në Komisionin për Zhvillimin e Organizatave të Kontabilitetit (PAODC) të FNK-së, Drejtoresha Ekzekutive e SHKÇAK-së, Znj. Ardiana Bunjaku, mori pjesë në takimet e rregullta të këtij Komisioni në Kampala, Ugandë dhe mëpastaj në Nju Jork, SHBA, si dhe në disa takime online.

Komisioni PAODC i FNK-së shërben si një këshilltar strategjik i rëndësishëm i FNK-së, duke kontribuar në mënyrë aktive në qëllimet strategjike të FNK-së. Kjo përfshinë rritjen e njohjes dhe identifikimit të zgjidhjeve për sfidat me të cilat ballafaqohet zhvillimi i organizatave profesionale të kontabilitetit si dhe promovimin, ngritjen dhe forcimin e këtyre organizatave në shërbim të interesit publik.

Në këto takime, anëtarët e Komisionit kanë zhvilluar udhëzime për të nxjerrë në pah praktikatat e mira të organizatave profesionale, për t'i shkëmbyer ato ndërmjet organizatave anëtare të FNK-së me qëllim të krijimit të një profesioni të fortë dhe për të dhënë zgjidhje për organizatat profesionale në sfidat që ato i kanë në zbatimin e standardeve ndërkombëtare. Si organizatë me reputacion, kontributi i SHKÇAK-së në këtë Komision është i çmueshëm, në veçanti në ofrimin e praktikave të mira për organizatat profesionale në vendet në zhvillim.

Si pjesë e këtij Komisioni, Shoqata ka dhënë kontributin e saj edhe në zhvillimin e udhëzuesit me shembuj praktik në forumin e donatorëve globalë të projektit MOSAIC të FNK-së, udhëzues ky i dedikuar donatorëve në mënyrë që ata t'i kuptojnë fushat kyçe, teknike dhe financiare për të cilat shoqatat profesionale kanë nevojë për mbështetje në mënyrë që ato të bëhen shtylla të profesionit dhe zhvillimit ekonomik në vendet e tyre.

ShKÇAK mbështetë reformat efektive në Menaxhimin e Financave Publike

ShKÇAK, me misionin për t'i shërbyer interesit publik vazhdimisht është e angazhuar në zhvillimin dhe përfaqësimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit por edhe në adresimin e nevojave dhe boshllëqeve të Kosovës që e pengojnë vendin drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Që nga themelimi, Shoqata ka bashkëpunuar me donatorë dhe projekte të shumta duke ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.

Me qëllim të adresimit të kësaj çështjeje dhe "vendosjes së financave në qendër të vendimmarrjes", ShKÇAK synon që së bashku me donatorët dhe ata që janë të ngarkuar me realizimin dhe zbatimin e reformave, të krijojë përpjekje të përbashkëta që do të sigurojnë sinergji dhe shfrytëzim efikas të burimeve për të arritur këtë objektiv të përbashkët për reformimin e sistemit të MFP-së në Kosovë. Si pikënisje, ShKÇAK konsideron se Strategjia për reformimin e MFP-së mund të japë rezultate pozitive në një periudhë relativisht të shkurtër, nëse do të mund të koordinohen fondet dhe të kemi një lidhshmëri të lartë, ambicioz dhe bashkëpunues, i cili do ta menaxhojë ndryshimin.

Ajo çka kërkohet është vazhdimi i bashkëpunimit të fortë ndërsektorial; zbatimi më i mirë i standardeve ndërkombëtare të kualitetit të lartë për raportimin financiar, auditimin dhe etikën; burime njerëzore të kualifikuara të cilët do t'i zbatojnë reformat; dhe rritja e interesit ndërkombëtar në menaxhimin e financave publike.



Takimi për koordinimin e donatorëve në mbështetje të SRMFP-së

Megjithatë, në asnjë mënyrë nuk janë këto mjetet e vetme që do të ndikojnë në përmirësimin e MFP-së. Por nëse implementohen, ato do ta përmirësojnë performancën brenda sektorit dhe rrjedhimisht do të rrisin besimin në institucionet politike.

Në këtë drejtim, është organizuar takimi për koordinimin e donatorëve për t'i bashkuar të gjithë donatorët dhe akterët relevantë që kanë ndihmuar dhe vazhdojnë të ndihmojnë Kosovën në reformimin e menaxhimit të financave publike dhe administratës publike. Në takim morën pjesën përfaqësues të UNDP-së, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, Zyrës së BE-së në Kosovë, USAID, agjencisë gjermane për zhvillim GIZ dhe përfaqësues të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Pjesëmarrësit i diskutuan modalitetet për ta mbështetur Qeverinë e Kosovës në hartimin dhe implementimin e reformave ekonomike të parapara në Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) të Kosovës 2016-2020, duke pasur parasysh se këto reforma shihen si thelbësore për zbatimin e duhur të politikave të Bashkimit Evropian, si dhe për arritjen e qëndrueshme të objektivave të zhvillimit ekonomik të vendit. ShKÇAK i prezantoi para donatorëve katër mënyrat kryesore me të cilat performanca dhe përgjegjësia në MFP mund të përmirësohet, e të cilat janë:

Plani i Veprimit për implementim

Reformimi i sistemeve të MFP-së duhet të planifikohet siç duhet për të siguruar që qeveria ka burimet e nevojshme në dispozicion. Duhet të ketë një angazhim serioz nga qeveria aktuale për zbatimin e planit të veprimit dhe reforma e MFP-së duhet të jetë në krye të listës së prioritetëve. Prandaj, Qeveria duhet të sigurohet që nëse është dakord për reformën, ata do të gjejnë mbështetje në gjetjen e burimeve të nevojshme.

Të sigurohet një kornizë e vetme

Një qasje e tërë sistemit është një model i MFP-së që siguron që elementet e një sistemi të MFP-së të veprojnë në një mënyrë konsistente dhe reciprokisht përforcuese. Për shembull, shumë shpesh buxheti dhe kontabiliteti, veprojnë sipas masave të ndryshme të flukseve të burimeve dhe pozicionit fiskal. Një qasje e tërë sistemit bashkon të gjithë elementët kryesorë të një sistemi të fuqishëm të MFP në një kornizë të vetme, e cila siguron funksionimin e sistemit në një mënyrë efektive dhe koherente.

Të zvogëlohet toleranca e korrupsionit nëpërmjet të dhënave dhe analizave

Të dhënat dhe analiza e të dhënave mund të forcojnë në masë të madhe luftën kundër korrupsionit. Mjete të tilla i pajisin qeveritë me informata për të identifikuar këto sjellje dhe aktivitete mashtruese. Për shembull, Komisioni i BE-së filloi programin e analitikës së të dhënave që kontrollon të dhënat përgjatë organizatave publike dhe të sektorit privat, për të identifikuar konfliktet e interesit. Për të siguruar që këto lloj programesh të miratohen dhe zbatohen duhet të ketë një vullnet më të madh brenda sistemeve politike për të ulur korrupsionin.

Rritja e transparencës duke publikuar rregullisht pasqyrat financiare

Me qëllim që të sigurohet një kontroll publik i vazhdueshëm i gjendjes financiare të qeverive, pasqyrat e plota financiare (bazuar në akrualet) duhet të publikohen rregullisht. Do të jetë shumë pozitive nëse Kosova do të publikojë llogaritë e saj çdo muaj, brenda gjashtë javëve pas përfundimit të muajit. Kjo do të thotë që publiku është i vetëdijshëm për çdo ndikim financiar negativ të vendimeve të qeverisë dhe si rezultat i vëmendjes së publikut, ministrat mund të jenë shumë më të përgjegjshëm sa i përket financave.

Katër mënyrat e prezantuara nga Shoqata për ngritjen e performancës dhe përgjegjësisë në MFP u mirëpritën nga donatorët dhe njëherit shënojnë hapat e parë drejt koordinimit të mbështetjes në implementimin e SRMFP-së. Takimi koordinues me donatorë ofroi mundësi për koordinimin e iniciativave të përbashkëta dhe për një vizion të përbashkët në mbështetjen e Qeverisë së Kosovës. Nga ky takim doli konstatimi i përbashkët për shkëmbimin e rezultateve të aktiviteteve të zhvilluara drejt reformave nga secila organizatë individualisht, në mënyrë që të mos dyfishohen aktivitetet për të njëjtat objektiva dhe për ta vazhduar komunikimin drejt aktiviteteve të koordinuara për SRMFP efektive.



Takimi për koordinimin e donatorëve në mbështetje të SRMFP-së

Shoqata bëhet pjesë e programeve të reja të Qendrës për Reforma në Raportim Financiar të Bankës Botërore

Shoqata tashmë disa vite është pjesë e Komuniteteve të Praktikës për Edukim dhe Raportim Financiar të organizuar nga QRRF në kuadër të programit EU-REPARIS të Bankës Botërore dhe si e tillë ka marrë pjesë në një varg seminaresh dhe trajnimesh të këtij programi. Falë angazhimit dhe punës së saj në zhvillimin e profesionit në Kosovë në sektorin privat dhe publik, ShKÇAK është bërë pjesë e dy programeve të reja të QRRF-së së Bankës Botërore: Programit dyvjeçar për ndërtimin e kapaciteteve rajonale për auditorët e brendshëm të sektorit publik - Trajnimi i Trajnerëve në Auditim të Brendshëm, që është organizuar nga QRRF e Bankës Botërore në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Praktikës së Auditimit të Brendshëm (IACOP) të rrjetit të Edukimit 'peer assisted' për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike (PEMPAL), si dhe programin PULSAR për zhvillimin e kontabilitetit dhe raportimit në sektorin publik, organizuar nga QRRF e Bankës Botërore.

Përmes programit dyvjeçar Trajnimi i Trajnerëve në Auditim të Brendshëm, trajnerët pjesëmarrës do të kenë mundësinë për të ofruar trajnime të cilësisë së lartë në fushën e auditimit të brendshëm në vendet dhe institucionet e tyre, bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm (SNPPAB) dhe praktikat e mira ndërkombëtare në auditim të brendshëm të sektorit publik. Vendet përfituese të këtij trajnimi janë Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia. Trajnerët e ShKÇAK-së dhe të Njësisë Qendrore Harmonizuese (NJQH) të Ministrisë Financave janë përzgjedhur të marrin pjesë në këtë program dyvjeçar, si përfaqësues nga Kosova.



Nga e majta: Piotr Pyziak, Teuta Karameta, Kalina Sukarova, Mentor Hyseni

Programi PULSAR është program në nivel rajoni dhe vendi në mbështetje të zhvillimit të kornizave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik, që ofron një platformë për shkëmbimin e njohurive drejt rritjes së llogaridhënies, transparencës dhe performancës së qeverive.

Objektiva e këtij programi është dhënia e mbështetjes për përmirësimin e kornizave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik në trembëdhjetë vende: Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Gjeorgji, Kosovë, Kroaci, Mal të Zi, Maqedoni, Moldavi, Serbi, Shqipëri dhe Ukrainë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me praktikat e mira, në mënyrë që të rritet llogaridhënia, transparenca dhe performanca e qeverive.

Shoqata e përfaqëson Kosovën në këtë trajnim së bashku me Departamentin e Thesarit dhe Njësinë Qendrore Harmonizuese, të Ministrisë së Financave.

Në takimin inaugurues të programit PULSAR, në panel diskutimin me temën "Edukimi për Kontabilitetin në Sektorin Publik si Katalizator i Reformave", përfaqësuesja e ShKÇAK-së prezantoi mbi përvojën e Shoqatës në zhvillimin e programeve të edukimit të sektorit publik dhe kontributin e saj në reformat në raportimin financiar në sektorin publik në Kosovë.



Ardiana Bunjaku në panelin
"Edukimi për Kontabilitetin në Sektorin Publik
si Katalizator i Reformave", PULSAR

Njëkohësisht, ShKÇAK ka vazhduar aktivitetin në trajnimet ekzistuese dhe seminarët e programit EU-REPARIS të QRRF-së së Bankës Botërore. Shoqata mori pjesë në punëtorinë dyditore "Konkluzionet dhe raportimi i auditimit", ku morën pjesë trajnerët nga Organizatat Profesionale të Kontabilitetit dhe organizatat tjera përgjegjëse që hartojnë dhe ofrojnë programe të trajnimit të EVP-së për auditorët ligjorë dhe firmat e auditimit.

Punëtorja kishte për qëllim zhvillimin e profesionit të auditimit në ofrimin e trajnimeve cilësore dhe Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) bazuar në standardet e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS) dhe u përqendrua në nevojat dhe sfidat e praktikave të vogla dhe të mesme (PVM)

në zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe në ofrimin e udhëzimeve për auditorët në zhvillimin e procedurave të sigurimit të cilësisë. Punëtorja ishte edhe forum për pjesëmarrësit për t'i diskutuar sfidat aktuale të EVP-së dhe për t'i gjetur zgjidhjet e përbashkëta. Kjo punëtori u mbajt me mbështetjen e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit (FNK).

Në Forumin Regjional mbi Praktikat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (PVM), organizuar nga QRRF e Bankës Botërore dhe FNK, përfaqësuesit e ShKÇAK-së kanë prezantuar në disa panele: mbi zhvillimet në fushën e standardeve të etikës dhe rreth Standardit të sapolësuar të BSNEK-së, "Kundërpërgjigja ndaj Mospajtueshmërisë me Ligjet dhe Rregullativat" (NOCLAR), mbi mundësitë dhe sfidat me të cilat Shoqata është ballafaquar që të zhvillojë një qasje moderne për edukim në kontabilitet dhe auditim dhe mbi praktikat e mira që ShKÇAK i aplikon në çështjet që kanë të bëjnë me përvojën praktike, edukimin e vazhdueshëm profesional, vlerësimin e kompetencave profesionale dhe sigurimin e cilësisë.

ShKÇAK ka kontribuar edhe në seminarin "AVANCIMI I RREGULLIMIT TË KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT: Përmirësimi i pajtueshmërisë përmes kontrollit dhe zbatimit më të mirë si dhe kërkesat adekuate për raportim jofinanciar", ku u diskutua për rolin dhe rëndësinë e mbikëqyrjes publike të auditimit në rregullimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e punës së auditorëve ligjorë drejt avancimit të njohurive të pjesëmarrësve për rolin dhe praktikat e sistemeve të mbikëqyrjes publike dhe kontrollit të cilësisë së auditimit, përfshirë edhe raportimin e tyre. Në seminar u shqyrtuan edhe elementet e raportimit jofinanciar të përgatitur nga shoqëritë tregtare në Bashkimin Evropian.

Pjesëmarrësit i shkëmbyen përvojat me njëri tjetrin dhe me zyrtarët e BE-së për reformat në fuqizimin e sistemeve të mbikëqyrjes publike dhe kontrollit të cilësisë së auditimit në pjesë të ndryshme të botës. Ajo çka u theksua është se të gjitha vendet e rajonit janë duke e ndryshuar apo azhurnuar ligjet për raportim financiar dhe se një ndër sfidat kryesore ishte gjetja e modelit adekuat të mbikëqyrjes publike për sigurimin e cilësisë së auditorëve ligjorë. Në këtë seminar, përfaqësuesi i ShKÇAK-së e njehërit edhe përfaqësues i KKRF-së, bëri prezantimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në Kosovë si nga aspekti i rregullatorit, KKRF ashtu edhe nga aspekti i shoqatës profesionale, ShKÇAK.

Si pjesë e bashkëpunimit me QRRF të Bankës Botërore, ShKÇAK i ka dhënë inputet dhe informatat për pyetësorin e QRRF-së, që i është dërguar shoqatave profesionale në Ballkanin Perëndimor, i cili ka për qëllim mbledhjen e pikëpamjeve dhe ideve të shoqatave drejt një harmonizimi dhe integrimi më të madh të programeve të edukimit të shoqatave profesionale në rajon, për të arritur një nivel më të lartë të njohjeve ndërkombëtare.



Forumi Regjional mbi Praktikën e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme



Nga e majta: Hysen Qela, Ardiana Bunjaku, Permtim Iseni, Mehmet Gjokaj, Arbër Hoti

Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit për Kontabilitet dhe Auditim të QRRF-së së Bankës Botërore

Sistemet e qëndrueshme të edukimit për kontabilitet dhe auditim e përmirësojnë kompetencën e kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë dhe kontribuojnë në rritjen e besimit të publikut në cilësinë e punës së tyre.

Nxitja e rritjes gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike është element kyç kundër varfërisë dhe rritjes së prosperitetit. Ekonomitë në rritje krijojnë vende pune, gjenerojnë të hyra, krijojnë përfitime sociale dhe tërheqin investime. Kjo është me rëndësi të veçantë për ekonomitë në zhvillim, qëllimet strategjike të zhvillimit të cilave përfshijnë përpjekje të konsiderueshme në përmirësimin e klimës së biznesit, rritjen e qasjes në financa, forcimin e sektorit financiar nxitjen e rritjes së sektorit privat.

Dihet që informacioni financiar i besueshëm është jetik për funksionimin e tregjeve në mënyrë efikase dhe për rritjen ekonomike. Prodhimin e informacionit financiar me cilësi të lartë mbështetet nga sistemet e qëndrueshme të edukimit të kontabilitetit dhe auditimit, të cilat i zhvillojnë dhe i përmirësojnë kompetencat e kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë.



Diskutim mbi Studimin e Krahasueshmërisë së Edukimit për Kontabilitet dhe Auditim, QRRF, Banka Botërore

Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit për Kontabilitet dhe Auditim është ndërmarrë me kërkesë të Komunitetit të Praktikës së Edukimit (EduCop) të Qendrës për Reforma në Raportimin Financiar të Bankës Botërore (ku ShKÇAK është anëtare), duke i pasur parasysh katër objektiva kryesore:

- ▶ shkëmbimin e praktikave të mira të universiteteve dhe organizatave profesionale të kontabilitetit dhe zhvillimin e zgjidhjeve për sfidat e përbashkëta përmes një procesi bashkëpunues, të cilin EduCoP e ka mundësuar duke iu ofruar pjesëmarrësve të rajonit të mësojnë nga njëri-tjetri dhe t'i shkëmbejnë njohuritë;
- ▶ eksplorimin e sinergjive në mes të edukimit akademik dhe profesional të kontabilitetit dhe auditimit si parakusht për zhvillimin e sistemeve adekuate të edukimit për kontabilitet dhe auditim dhe sigurimin e përdorimit efektiv të burimeve të edukimit në nivel vendi;
- ▶ zbatimin e një "qasjeje të rezultateve të të nxënit" në edukimin për kontabilitet dhe auditim bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (SNE) dhe praktikën e mira ndërkombëtare si një përvojë më efektive e të mësuarit;
- ▶ dhe mundësinë e një diagnostikimi që synon të ndihmojë anëtarët e EduCop që të angazhohen në një proces të njohjes dhe akreditimit ndërkombëtar të programeve kombëtare.



Profili i studimit, Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit, Qendra për Reforma në Raportim Financiar, Banka Botërore, 2017.

Gjashtë vende, Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, anëtare të EduCop kanë marrë pjesë në Studimin e Krahaseshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit gjatë periudhës mars 2015- maj 2016. Studimi është një vlerësim gjithëpërfshirës i 14 universiteteve dhe organizatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit të këtyre vendeve, të cilat gjithsej i ofrojnë 25 programe edukimi akademik dhe profesional me rreth 4,120 studentë të regjistruar.

Përmbajtja e kurrikulës, rezultatet e të nxënit dhe nivelet e aftësisë nga këto programe të edukimit për kontabilitet janë analizuar duke i përdorur Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (SNE) lidhur me kompetencën teknike (SNE 2) dhe vlerat profesionale, etikën dhe qëndrimet (SNE 4). Është bërë krahasim shtesë i përmbajtjes së syllabuseve dhe lëndëve me ato të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar të Britanisë së Madhe (ACCA) dhe Institutit të Licencuar për Financa Publike dhe Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA).


Studimi e ka identifikuar një numër mundësish që mund të shqyrtohen në reformat e ardhshme të edukimit për kontabilitet dhe auditim. Këto mundësi paraqesin fusha të rëndësishme që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm gjatë zhvillimit të edukimit për kontabilitet dhe auditim në rajon dhe mund të çojnë në:

- ▶ njohjen e përfitimeve të kualifikimeve, çertifikimit dhe proceseve të licensimit, duke siguruar konsistencë më të madhe në ofrimin e shërbimeve të kualitetit të lartë të industrisë apo të sektorit, nga individët për publikun;
- ▶ përmirësimin e reputacionit të ofruesve të programeve të edukimit dhe rritjes profesionale të individëve;
- ▶ instalimi i një shkalle më të lartë të llogaridhënies për ofruesit e programeve të edukimit të kontabilitetit dhe auditimit dhe për individët në zhvillimin dhe mbajtjen e kompetencave të tyre.


Studimi gjithashtu i propozon disa këshilla praktike, të cilat, në kombinim me praktikatat e mira të identifikuar, mund t'u ndihmojnë ofruesve të edukimit për kontabilitet dhe auditim që t'i shfrytëzojnë mundësitë kyçe dhe të zbatojnë reformat.

Mundësitë e identifikuar në zhvillimin e edukimit për kontabilitet dhe auditim janë si në vijim: integrimi i edukimit akademik dhe profesional për kontabilitet dhe auditim; arritja e integritetit më të madh ndërkombëtar të programeve; zgjerimi i ofertave për edukim në sektorin publik, përmirësimi i sistemeve të EVP-së dhe programeve të trajnimeve; përmirësimi i kërkesave të përvojës praktike dhe vlerësimit të vendeve të punës.

Burimet kryesore të financimit



Burimet kryesore të financimit, Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit, Qendra për Reforma në Raportim Financiar, Banka Botërore, 2017.



Profili gjinor, Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit, Qendra për Reforma në Raportim Financiar, Banka Botërore, 2017.

Duke e pasur parasysh faktin që edukimi për kontabilitet dhe auditim dallon nga vendi në vend, një nga sfidat e studimit ka qenë përgjithësimi i të dhënave, prandaj studimi i ka identifikuar dhe hulumtuar çështjet që janë të rëndësishme dhe të përbashkëta në edukimin për kontabilitet dhe auditim në secilin vend. Studimi i analizon në nivel të rajonit dhe në nivel të vendit, çështjet në vijim: burimet e financimit, burimet dhe kapacitetet, kërkesat dhe trendet e përgjithshme, profilin gjinor, njohjet dhe akreditimet ndërkombëtare, krahasimi i kurrikulave, etika, vlerat dhe qëndrimi profesional si Edukimi i Vazhdueshëm Profesional. Studimi po ashtu i ka theksuar edhe praktikatat e mira të secilës organizatë të anketuar (universitet apo shoqatë profesionale).


Në Kosovë, subjekte të studimit kanë qenë ShKÇAK dhe Universiteti i Prishtinës, përkatësisht Fakulteti Ekonomik, programi i kontabilitetit. Studimi i analizon programet e edukimit dhe trajnimit, personelin mësimor, strukturën e studentëve dhe anëtarëve, EVP-të, njohjet si dhe bën krahasimin e planprogrameve kundrejt SNE-së, programeve të ACCA-së dhe të CIPFA-së.




Profili i studimit në Kosovë, Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit, Qendra për Reforma në Raportim Financiar, Banka Botërore, 2017.

Mbi programet e edukimit të ShKÇAK-së, studimi thotë: “Programi i edukimit dhe trajnimit profesional i ShKÇAK-së bazohet në programin e ACCA-së, ku kandidatëve të suksesshëm u ofrohet një nivel i lartë i njohjeve. ShKÇAK e ka një strategji mirë të ndërtuar për zhvillim të karrierës për tërheqjen e kandidatëve të kalibrit të lartë në profesion dhe gjithashtu bashkëpunon ngushtë me institucionet e arsimit të lartë në vend”.

Vlen të theksohet se të gjeturat e krahasueshmërisë së planprogrameve kanë treguar se planprogrami i ShKÇAK-së është në pajtueshmëri të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit; “Programi i edukimit i ShKÇAK-së është i pozicionuar mirë kundrejt SNE-së, me vetëm disa përmirësime që nevojiten në fushat Mjedisi Organizativ dhe i Biznesit, dhe Kontabiliteti dhe Raportimi Financiar, për t’i përmbushur tërësisht të gjitha rezultatet e të mësuarit. Kalimi nga kualifikimi Kontabilist i Çertifikuar në kualifikimin Auditor i Çertifikuar në aspekt të nivelit profesional është mjaft i mirë”.




Profili i planprogramit të ShKÇAK-së kundrejt SNE-së, Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit, Qendra për Reforma në Raportim Financiar, Banka Botërore, 2017.




Profili i planprogramit të ShKÇAK-së kundrejt ACCA-së, Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit, Qendra për Reforma në Raportim Financiar, Banka Botërore, 2017.


Te krahasueshmëria e planprogramave të Universitetit të Prishtinës, studimi thotë: “Raportimi Financiar i Sektorit Publik mbulohet pak nga të dy programet, baçelor dhe master. Krahasuar me standartet e SNE-së dhe ACCA, forcimi i kurrikulave në Kontabilitet dhe Raportim Financiar, Menaxhment Financiar, Auditim dhe Siguri, Përkushtim ndaj Interesit Publik, Etikë dhe TI mund të japë rezultate më të larta për krahasim.”



Profili i planprogramit të Universitetit të Prishtinës kundrejt SNE-së, Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit, Qendra për Reforma në Raportim Financiar, Banka Botërore, 2017.



Profili i planprogramit të Universitetit të Prishtinës kundrejt ACCA-së, Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit, Qendra për Reforma në Raportim Financiar, Banka Botërore, 2017.



Profili i planprogramit të Universitetit të Prishtinës kundrejt CIPFA-së, Studimi i Krahasueshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit, Qendra për Reforma në Raportim Financiar, Banka Botërore, 2017.

Në këtë studim, Shoqata po ashtu u vlerësua për praktika të mira në disa fusha si: në veprimin e shpejtë ndaj nevojave të ndryshme të profesionistëve kontabilistë dhe auditorë, me materiale të cilësisë së lartë dhe të azhurnuara, në promovimin e rolit të rëndësishëm të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në shërbim të interesit publik, në zbatim të sigurisë, përpikërisë dhe kontrollit të cilësisë gjatë vlerësimit të provimeve dhe me ofrim të mjeteve dhe udhëzimeve për t'i përbushur kërkesat për përvojë praktike dhe aftësi profesional.



PRAKTIKAT E MIRA

Materiale të cilësisë së lartë dhe të azhurnuara

Materialet mësimore dhe tekstet shkollore të ShKÇAK-së janë të definuara mirë dhe i përmbajnë rezultatet e të mësuarit, metodologjinë e provimeve dhe kompetencat përkatëse. Secili libër mësimor shoqërohet me ushtrime dhe shembuj të provimeve që i simulojnë problemet e provimit, të dizajnuara për qëllime praktike të kandidatit. Materialet e studimit azhurnohen dhe rishikohen në baza vjetore.

ShKÇAK i ka zbatuar disa praktika të mira për ta ruajtur cilësinë e lartë të materialeve të saj të mësimdhënies:

- ▶ ShKÇAK ka lidhur marrëveshje me BPP Professional Education në Britaninë e Madhe. Këto materiale azhurnohen në baza vjetore për të siguruar se janë në hap me ndryshimet në zhvillimet e kontabilitetit dhe auditimit.
- ▶ ShKÇAK bashkëpunon me firma profesionale të auditimit dhe kontabilitetit në aspekte që kanë të bëjnë me azhurnimin e përmbajtjes së planprogrameve në fushat si tatimet dhe ligjet në Kosovë. Bëhen ndryshimet e nevojshme në programin e edukimit dhe materialet mësimore azhurnohen në baza vjetore.

Praktikat e mira të ShKÇAK-së, Studimi i Krahueshmërisë së Edukimit të Kontabilitetit dhe Auditimit, Qendra për Reforma në Raportim Financiar, Banka Botërore, 2017.

Thellim i bashkëpunimit me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në shërbim të interesit publik në Kosovë dhe Shqipëri

Këshilli i ShKÇAK-së dhe Këshilli Drejtues i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) kanë zhvilluar takim të përbashkët, me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit dhe komunikimit reciprok. Në takim u diskutuan aktivitetet e përbashkëta, të cilat në një mënyrë kritike do ta vlerësonin shkallën e zhvillimit aktual ekonomik të dy vendeve, bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar të deritanishëm, ecurinë e tyre në proceset integruuese evropiane, dhe veçanërisht, duke e pasur parasysh rolin që e ka dhe mund ta luajë profesioni për një raportim financiar të besueshëm, nxitjen e mëtejshme të zhvillimit ekonomik, promovimin e investimeve vendase e të huaja, etj.

Në këtë kontekst, dy shoqatat u dakorduan që të punojnë drejt hartimit të një plani konkret të përbashkët, në mënyrë që të bashkuar të sensibilizojnë të gjithë akterët, faktorët dhe publikun, me qëllim të promovimit të profesionit në të dyja anët e kufirit, të evidentojnë më mirë rolin e shërbimeve të anëtarëve tanë, në funksion të një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe krijimit të një shoqërie me standarde të avancuara.



Konferenca e IV Ndërkombëtare e IEKA-së

Gjatë këtij viti, ShKÇAK ishte pjesë edhe e Konferencës së Katërt Ndërkombëtare “Sfidat e aditorit në një mjedis ekonomik vazhdimisht të ndryshueshëm”, organizuar nga IEKA me rastin e përvjetorit të 20-të të themelimit të saj, ku morën pjesë edhe zyrtarë të lartë të Qeverisë së Shqipërisë, Kontrollit të Lartë të Shtetit, përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, të FNK-së, FCM-së, si dhe shoqatave profesionale nga rajoni dhe bota. Në seancën e konferencës mbi përmirësimin e kualifikimeve profesionale, si një faktor i rëndësishëm për suksesin e profesionit në të ardhmen, pjesë e panelit ishte edhe Kryetari i ShKÇAK-së, Z. Nazmi Pllana, i cili prezantoi për përvojën e ShKÇAK-së në zhvillimin e programeve certifikuese në Kosovë, sfidat dhe perspektivat.

Bashkëpunim i ngushtë me akterët relevantë dhe palët e interesit në vend

ShKÇAK në vazhdimësi e ka theksuar nevojën për bashkërendim të të gjithë akterëve relevantë në avansimin e profesionit, meqë përpjekjet e përbashkëta dhe të koordinuara janë element kyç drejt zhvillimit ekonomik të vendit dhe integritimit të tij në organizatat ndërkombëtare. Rrjedhimisht, ShKÇAK vazhdon ta mbajë një komunikim dhe bashkëpunim të ngushtë me KKRF-në, AKK-në, institucionet e Kosovës, komunitetin e biznesit, organizatat ndërkombëtare në Kosovë dhe të gjitha palët tjera të interesit që veprojnë në Kosovë, duke dhënë kontribut në zhvillimet në vend por edhe duke i mbrojtur dhe promovuar interesave e anëtarëve të saj.

Gjatë vitit 2017, ShKÇAK është ftuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) për të prezantuar të arriturat e ShKÇAK-së. Qëllimi i prezantimit në njërën anë ishte prezantimi i të arriturave kryesore të Shoqatës në vitin 2016 si dhe planifikimin e arritjes së objektivave për vitin 2017/2018 dhe në anën tjetër monitorimi i këtyre të arriturave nga KKRF.



Gem Maloku, Kryesues i KKRF-së

ShKÇAK bëri prezantim gjithëpërfshirës mbi përmbushjen e Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të FNK-së si rishikimi i procedurave të qeverisjes dhe procedurave financiare, zhvillimi i sistemit të kontrollit të cilësisë, ngritja e kapaciteteve profesionale në vend në pajtim me SNE-të. Ndër të tjera, Shoqata prezantoi edhe për të arriturat tjera në vitin 2016, si: zhvillimi i programeve të reja certifikuese, mirëmbajtja e cilësisë profesionale të anëtarëve, akreditimi i të gjitha programeve certifikuese të ShKÇAK-së nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), si dhe anëtarësimi në Federatën Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA).

Përveç të arritura në vitin 2016, përfaqësuesit e Shoqatës i prezantuan edhe objektivat për vitin 2017/2018 si: rritja e besueshmërisë në Pasqyra Financiare me anë të Kontrollit të Cilësisë, vazhdimi i njohjeve reciproke të certifikimeve me organizatat profesionale globale si ACCA, CIPFA, AAT, vazhdimi i bashkëpunimit dhe mbikëqyrjes së programeve universitare për kontabilitet dhe auditim për Institucionet e Arsimit të Lartë, vazhdimi i bashkëpunimit me palët e interesit përmes ekspertizës profesionale për zhvillim ekonomik të vendit, përfaqësimi i vendit në organizatat ndërkombëtare FNK, EFAA, FCM, Bankë Botërore etj.

Prezantimi i ShKÇAK-së mori vlerësime pozitive nga KKRF për gjithë punën e bërë. KKRF nuk pati kërkesa shtesë për Shoqatën që njëherit tregon plotësueshmëri të kërkesave të rregullatorit.

Një prej sfidave me të cilat ballafaqohet vendi ynë është dukuria e ekonomisë joformale e cila shkaktohet nga faktorë të shumtë. Në kuadër të këtyre faktorëve është edhe pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit që paraqesin rrezik të madh për ekonominë e vendit por edhe për sigurinë e qytetarëve. ShKÇAK vazhdimisht, e sidomos në vitet e fundit pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, që i referohet luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ka punuar në mënyrë intensive në vetëdijesimin e anëtarëve të saj për përgjegjësitë dhe obligimet që i kanë si subjekte raportuese.



Në këtë drejtim, Shoqata ka zhvilluar disa sesione të trajnimit të anëtarëve me Njësinë e inteligjencës Financiare (NJIFK) në të cilat anëtarët janë pajisur me njohuri të reja në fushën e zbatimit të Ligji Nr. 05/L-096 për Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Duke e konsideruar si tejet të rëndësishëm rolin dhe kontributin e anëtarëve të Shoqatës në zbatimin e Ligji Nr. 05/L-096 për Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, anëtarët e Shoqatës kanë marrë pjesë edhe në trajnimin dyditor të organizuar nga "Projekti i Përbashkët BE/Këshilli i Evropës kundër Krimin Ekonomik në Kosovë (PECK II)", në të cilin trajnim kanë marrë pjesë 10 anëtarë të Shoqatës.

Ky trajnim është organizuar për Bizneset dhe Profesionet e Përcaktuara jo-Financiare (BPPjF) që për temë kryesore ka pasur rolin dhe rëndësinë e BPPjF në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, standardet ndërkombëtare dhe zhvillimet e fundit në këtë fushë, kornizën ligjore dhe rregullatore ndërkombëtare dhe vendore lidhur me pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit.

Rëndësi e veçantë në këtë trajnim i është dhënë menaxhimit të rreziqeve të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (PP/FT) si dhe masave për menaxhimin e rrezikut, raportimit të transaksioneve të dyshimta si dhe përcaktimit të procedurave të raportimit të brendshëm.

Anëtarët e Shoqatës pjesëmarrës në këtë trajnim duke u mbështetur në obligimet dhe përgjegjësitë që dalin ngak ligj, i kanë shprehur pikëpamjet e tyre për luftimin e kësaj dukurie që në formën e saj ndikon në rritjen e ekonomisë joformale dhe rrezikimin e sigurisë së qytetarëve. Pjesëmarrësit nga ShKÇAK sidomos e theksuan rëndësinë e Kodit të Etikës si udhërrëfyes të profesionistëve për punë të ndershme dhe raportim konform kërkesave ligjore.

Që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocijimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian (BE) në vitin 2015 që paraqet edhe marrëveshjen e parë kontraktuale të Kosovës me BE-në, nga institucionet relevante, respektivisht nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ShKÇAK është identifikuar si një prej organizatave të rëndësishme që mund të kontribuojë në reformat e legjislacionit të Kosovës. Shoqata është inkuorpuar në grupin punues të MTI-së e cila ka qenë e përkrahur nga Projekti i BE-së "Asistenca për Implementimin e MSA-së - Direktiva e BE-së për Shërbimet".

Qëllimi themelor i punës së këtij projekti, pjesë e së cilës ka qenë edhe ShKÇAK, ishte identifikimi i legjislacionit primar dhe atij sekondar që duhet të harmonizohet me legjislacionin e BE-së, respektivisht me Direktivën e Shërbimeve të BE-së e cila ka për qëllim lehtësimin e qarkullimit të shërbimeve brenda dhe jashtë kufijve.

Në këtë drejtim, Shoqata gjithnjë e ka shprehur gatishmërinë për ofruar ekspertizën e saj sidomos në çështjet të cilat janë të lidhura me profesionin, e në veçanti me legjislacionin që e rregullon këtë fushë.

Si anëtarë e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), ShKÇAK vazhdimisht angazhohet në trajtimin e temave të rëndësishme për komunitetin biznesor në Kosovë. Në këtë drejtim, Shoqata i është përgjigjur kërkesës së OEAK-së për komentimin e Projekltigjit për Shoqëri Tregtare. Komentet kryesisht i janë drejtuar emërimit të ligjit, në mënyrë që të jetë më në harmoni me fushëpverimin e tij dhe Direktivën e BE-së, me definicionet përbenda ligjit, në mënyrë që të arrihet qartësi më e lartë e dispozitave ligjore dhe me plotësimin e neneve të ndryshme, për të pasur një ligj më kuptimplotë.

Gjithashtu, si anëtare e Komitetit për Tatime të OEAK-së, ShKÇAK ka trajtuar çështje nga legjislacioni tatimor. Shoqata poashtu ka marrë pjesë në konferencat e Odës Amerikane në Kosovë, me tema relevante si "Procedurat e falimentimit: Çfarë duhet të dini", "Arbitrazhi i investimeve", dhe "Shkathtësitë, punësimi dhe rritja", ku u prezantua "Studimi mbi Boshllëkun e Shkathtësive të Fuqisë Punëtore" i OEA-së, sipas të cilit, boshllëku më i madh i shkathtësive është paraqitur në sektorët e prodhimit dhe shërbimeve, veçanërisht në profile teknike që zakonisht mësohen në shkollë të arsimit dhe aftësimit profesional.



Si anëtare e Zyrës së Komunitetit të Biznesit (ZKB) pranë Kuvendit të Kosovës, përfaqësuesit e Shoqatës kanë kontribuar së bashku me anëtarët e tjerë në përmirësimin e legjislacionit për fusha të ndryshme, si në Ligjin për Sigurime Shëndetësore, ku është kërkuar që të shqyrtohet shkalla e premiumit prej 7%, definimi i saktë i të ardhurave bruto si bazë për pagesë të premiumit, si dhe është dhënë një koment i përgjithshëm se ky ligj nuk i plotëson kushtet për zbatim të sigurimit shëndetësor. Si pjesë e diskutimeve Brenda ZKB-së ka qenë edhe shqetësimi i ngritjes së pagave në sektorin publik, ku SHKÇAK iu ka bashkuar zërave që kanë shprehur shqetësimin për ngritjen e pagave në sektorin publik, të paralajmëruar nga Qeveria, për shkak se kjo ngritje do të ndikojë në orientimin e të rinjve drejt sektorit publik, e rrjedhimisht do të krijojë probleme me fuqinë punëtore në sektorin privat. Shoqata, duke pasur në qendër të veprimtarisë interesin publik, do të vazhdojë të bashkëpunojë me të gjitha palët e interesit për të krijuar një mjedis të përshtatshëm në të cilin profesioni do të arrijë një nivel të lartë të zhvillimit.



Studentët e Vitit 2017

Ofrimi i kushteve sa më të mira për studentët dhe stimulimi i tyre për rezultate më të mira janë gjithmonë në fokus të Shoqatës. Si mirënjohje për punën e bërë dhe rezultatet e arritura, ShKÇAK ka vazhduar traditën e shpalljes së çmimit Student i Vitit dhe në ceremoninë e fundivitit janë shpallur Studentët e Vitit për të tre nivelet. Studentëve fitues të këtij çmimi për vitin 2017 u dëshirojmë suksese drejt aspiratave të tyre të reja profesionale dhe i inkurajojmë të gjithë studentët që të vazhdojnë me ngritjen e performancës së tyre, meqenëse zhvillimi profesional i secilit është mirënjohja më e madhe ndaj punës së bërë.



Ermira Desku

Studente e Vitit e nivelit
Kontabilist i Çertifikuar

Burim Shala

Student i Vitit i nivelit
Teknik i Kontabilitetit

Hyrishahe Mustafa

Studente e Vitit e nivelit
Auditor i Çertifikuar

STUDENTËT
E VITIT 2017

Komisionet e Shoqatës

Komisionet e ShKÇAK-së janë shtylla të rëndësishme në qeverisjen e Shoqatës dhe luajnë rol kyç në arritjen dhe zhvillimin e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve të Shoqatës dhe përmbushjen e objektivave të Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të FNK-së.

Komisionet e Shoqatës i përcjellin zhvillimet në fushat përkatëse të profesionit në vend dhe në botë dhe angazhohen që objektivat dhe aktivitetet e Shoqatës t'i reflektojnë ato zhvillime në shërbim të interesit publik. Komisionet shërbejnë si urë lidhëse në mes të anëtarëve dhe akterëve relevantë të profesionit në krijimin e një mjedisi të avancuar të punës për kontabilistët dhe auditorët.

Në anën tjetër, Komisionet e ShKÇAK-së përkujdesen për ruajtjen e integritetit profesional të anëtarëve, respektimin e Kodit të Etikës nga ata dhe pajtueshmërinë e punës së tyre me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit, si dhe të edukimit.



Grupet punuese të përbashkëta me anëtarë të Këshillit dhe anëtarë të Komisioneve u mbledhën në punëtorinë dyditore, e cila u mbajt në Prevallë ku u zhvillua plani i punës së Komisioneve për vitin 2017/2018 sipas Planit Strategjik të ShKÇAK-së dhe DOA-ve të FNK-së.

DOA-të e FNK-së shërbejnë si kornizë për shoqatat profesionale kredibile, anëtare të FNK-së që janë të fokusuara në shërbim të interesit publik duke i zbatuar standardet ndërkombëtare dhe duke krijuar mekanizma që e ruajnë sjelljen profesionale të anëtarëve, andaj harmonizimi i aktiviteteve të Shoqatës me këto kërkesa është më se i rëndësishëm në mirëmbajtjen e qëndrueshmërinë së ShKÇAK-së.



Përmbledhje e të gjeturave dhe rekomandimeve nga raporti Dashboard Report i FNK-së mbi zbatimin e Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë nga ShKÇAK

FNK e ka publikuar Planin e Veprimit të ShKÇAK-së, plan ky që zhvillohet nga anëtarët e FNK-së për t'i adresuar çështjet e politikave në lidhje me vetëvlerësimin e pajtueshmërisë. Meqenëse Shoqata i ka përmbushur kërkesat e FNK-së dhe ka treguar nivel të lartë të pajtueshmërisë me këto kërkesa, ajo e ka përfituar të drejtën që ta azhurnojë Planin e Veprimit çdo dy vite, gjë që tregon për qëndrueshmërinë e Shoqatës dhe në këtë mënyrë nuk ka nevojë për monitorim nga FNK për çdo vit, sikur ndodh me shumë organizata tjera. Pas dorëzimit të planit të azhurnuar të veprimit, i cili i përfshinë fushat e aktiviteteve në bazë të Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) dhe publikimit të tij në ueb faqen e FNK-së, FNK e ka azhurnuar profilin e Kosovës, në bazë të informacioneve të dhëna nga Shoqata.

Njëkohësisht, FNK e ka përgatitur Dashboard Report, raport ky i cili e tregon përmbushjen e DOA-ve në nivel të shoqatave profesionale dhe në nivel kombëtar, e të cilin FNK e ka publikuar për herë të parë këtë vit. DOA-të ofrojnë një pikë të qartë referimi për anëtarët aktualë dhe të mundshëm të FNK-së dhe organizatave anëtare u kërkohet të kryejnë vetëvlerësime të vazhdueshme të të vepruarit të tyre në përputhje me secilën DOA. Këto Deklarata kërkojnë që organizata anëtare t'i shtojnë përpjekjet për t'i përmbushur obligimet e tyre.

Në vazhdim është paraqitur përmbledhja e Dashboard Report ku tregohet përmbushja e kërkesave të DOA-ve në nivel kombëtar – të rregullatorit dhe organizatave profesionale të vendit përkatës, si dhe statusi i përmbushjes së tyre në nivel të OPK-së anëtare të FNK-së (ShKÇAK), ku edhe definohet nëse përgjegjësia është përgjegjësi direkte e OPK-së anëtare, e institucionit përkatës, apo e përbashkët. Në raport shihet se ShKÇAK i ka përmbushur në nivel të lartë kërkesat e DOA-ve dhe për këtë është vlerësuar lartë nga stafi i FNK-së.




Tabela në vazhdim tregon se si FNK e vlerëson statusin e ShKÇAK-së në përmbushjen e DOA-ve dhe shërben si referencë për të parë statusin e ShKÇAK-së në përmbushjen e të gjitha DOA-ve, të cilat janë paraqitur në tabelat në vijim.

	Vlerësimi i FNK-së për statusin e përmbushjes së DOA
 Qëndro	OPK mban procese të qëndrueshme të vazhdueshme për t'i përmbushur detyrimet e saj përkatëse. Në përmbushjen e kësaj DOA, OPK konsideron, planifikon, ekzekuton, shqyrton dhe ngrit përmirësimin e vazhdueshëm si pjesë e një angazhimi të vazhdueshëm. ose Duke e pasur parasysh natyrën e mandatit të saj, përbërjen e anëtarësimit dhe mjedisin ligjor dhe rregullator, OPK nuk është e përfshirë në aktivitetet që lidhen me këtë fushë.
 Rishiko dhe përmirëso	OPK e ka përmbushur kohët e fundit detyrimin e saj përkatës dhe po e shqyrton planin e implementuar për të identifikuar dhe zbatuar përmirësime.
 Zbato	OPK demonstroi se po e zbaton planin
 Planifiko	OPK ka një plan të definuar për t'i përmbushur kërkesat e DOA-së.
 Në konsideratë	OPK po konsideron se si ti përmbushë kërkesat e DOA-së.
 Jo aktive	OPK nuk është aktive në fushën e DOA.

Në vazhdim janë paraqiture tabelat që tregojnë statusin e përmbushjes së DOA-ve në nivel kombëtar, përgjegjësinë e OPK-së anëtare (ShKÇAK), komentin e FNK-së, statusin e ShKÇAK-së në përmbushjen e DOA-së përkatëse si dhe rekomandimet e FNK-së për ShKÇAK-në.

DOA 1 – Sigurimi i cilësisë

	Vlerësimi i FNK-së për statusin e përmbushjes së DOA-së në nivel kombëtar
 Adoptuar	Është krijuar një sistem i rishikimit të Sigurimit të Cilësisë (SC) që përfshin kërkesat për DOA 1, dhe është funksional për të gjitha auditimet e obligueshme.
 Adoptuar pjesërisht	Është krijuar një sistem i rishikimit të SC-së që përfshin kërkesat për DOA 1 dhe është funksional për të gjitha auditimet e obligueshme.
 Nuk është adoptuar	Asnjë sistem rishikimi i SC-së nuk është krijuar.

DOA 1 Sigurimi i cilësisë

Statusi në nivel kombëtar	Përgjegjësia e OPK-së	Komente nga FNK	Statusi i ShKÇAK-së	Rekomandime
 Adoptuar pjesërisht	Jo direkte	Ligji Nr. 04 / L-014 përbën bazën ligjore për krijimin e sistemit të rishikimit të Sigurimit të Cilësisë (SC) në Kosovë. KKRF është autoriteti kompetent për kryerjen e rishikimeve të detyrueshme të sigurimit të cilësisë për auditorët ligjorë dhe firmat e licencuara. ShKÇAK në vitin 2008 themeloi Komisionin për Sigurim të Cilësisë dhe me ndihmën e Royal NBA (Holandë) ka organizuar një pilot sistem të rishikimit të SC-së me fushëveprim të kufizuar për auditimin e disa entiteteve të caktuara me interes publik. ShKÇAK 2015 ka themeluar Departamentin e SC-së i cili është përgjegjës për implementimin e SC-së për auditorët ligjorë, anëtarë të ShKÇAK-së. Procesi i rishikimit ka filluar në vitin 2016. KKRF dhe ShKÇAK janë duke punuar në zhvillimin e qasjes së përshtatshme të SC-së për Kosovë në përputhje me kërkesat e DOA 1. IKAF dhe AAB nuk kanë në dispozicion informacion që kanë krijuar sisteme të rishikimit të SC-së për anëtarët e tyre.	 Zbato	ShKÇAK inkurajohet të vazhdojë punën bashkëpunuese me palët e tjera të interesit për krijimin dhe funksionimin e një sistemi ligjor të rishikimit të cilësisë në juridiksion. ShKÇAK gjithashtu inkurajohet që gjatë raundit tjetër të azhurnimit të Planit të Veprimit të DOA-ve të kryejë një vlerësim të sistemit të saj të rishikimit të SC-së sipas kërkesave të DOA 1. Nëse ekzistojnë boshllëqe në përputhje, veprimet duhet të merren parasysh dhe të përfshihen brenda Planit të Veprimit për të sjellë sistem në përputhje me DOA 1.

DOA 2 – Standardet Ndërkombëtare të Edukimit

Vlerësimi i FNK-së për statusin e përmbushjes së DOA-së në nivel kombëtar	
 Adoptuar	Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (SNE) janë zbatuar për edukimin fillestar dhe të vazhdueshëm profesional të profesionistëve të kontabilitetit dhe auditimit si dhe partnerëve të angazhuar.
 Adoptuar pjesërisht	Nuk janë zbatuar të gjitha SNE-të. ose SNE-të janë zbatuar vetëm për profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit.
 Nuk është adoptuar	SNE-të nuk janë zbatuar.

DOA 2 - Standardet Ndërkombëtare të Edukimit

Statusi në nivel kombëtar	Përgjegjësia e OPK-së	Komente nga FNK	Statusi i ShKÇAK-së	Rekomandime
 Adoptuar pjesërisht	E përbashkët	Sipas Ligjit Nr. 04 / L-014, programi i certifikimit për kontabilistët dhe auditorët e certifikuar duhet të jetë në përputhje me SNE. KKRF është përgjegjës për përpilimin dhe lëshimin e standardeve për trajnimin profesional EVP për Auditorët e Certifikuar është e përcaktuar me ligj dhe i nënshtrohet monitorimit nga KKRF-ja. Kontabilistët e Certifikuar dhe Teknikët e Kontabilitetit nuk janë të obliguar që të ndjekin EVP. Certifikimi i kontabilistëve dhe auditorëve sipas ligjit kryhet nga shoqatat profesionale të licencuara (tri shoqata nga viti 2017). ShKÇAK, anëtare në FNK, ka zhvilluar programe të certifikimit që në përgjithësi i plotësojnë kërkesat e SNE-ve, sipas Edukimi në Kontabilitet, Banka Botërore 2017: Studimi i Kthasueshmërisë (Benchmarking Study). Nuk ka në dispozicion informacion nëse shoqatat e tjera profesionale, IKAF dhe AAB, të licencuara nga KKRF, kanë zhvilluar programe të certifikimit në përputhje me SNE-të. Programi i edukimit universitar, sipas Bankës Botërore, bie në disa fusha nga kërkesat e SNE dhe duhet të përafrohet më tej me programin e certifikimit profesional.	 Rishiko dhe përmirëso	SHKÇAK inkurajohet të hartojë planet për të rishikuar kërkesat e SNE-ve të rishikuara dhe të tregojë shtrirjen e harmonizimit të kërkesave kombëtare me standardet ndërkombëtare gjatë raundit tjetër të azhurnimit të Planit të Veprimit të DOA-së, si dhe të marrë në konsideratë aktivitetet që synojnë sjelljen e kërkesave kombëtare në përputhje me ato të SNE. Përveç kësaj, edhe pse ShKÇAK punon për të siguruar zbatimin e kërkesave të EVP, rekomandohet një monitorim më i fortë dhe një lidhje me sistemin e H & D.

DOA 3

DOA 3 – Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

	Vlerësimi i FNK-së për statusin e përmbushjes së DOA-së në nivel kombëtar
 Adoptuar	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) janë zbatuar në tërësinë e tyre në fuqi që nga koha e vlerësimit dhe janë efektive për aplikim në të gjitha auditimet e obligueshme.
 Adoptuar pjesërisht	Versioni i mëparshëm i SNA (2009+) u zbatua ose SNA-të janë të nevojshme të zbatohen në lloje të zgjedhura të auditimit.
 Nuk është adoptuar	SNA-të nuk janë zbatuar ose Është zbatuar versioni i SNA-ve para vitit 2009.

DOA 3 – Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

Statusi në nivel kombëtar	Përgjegjësia e OPK-së	Komente nga FNK	Statusi i ShKÇAK-së	Rekomandime
 Adoptuar	Jo direkte	Ligji Nr. 04 / L-014 kërkon që pasqyrat financiare të ndërmarrjeve të mëdha dhe të mesme të auditohen. Auditimet duhet të bëhen në përputhje me standardet dhe deklaratat e lëshuara nga BSNAS, të miratuara nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF). Standardet ndërkombëtare janë përkthyer nga Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) sipas marrëveshjeve formale me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA). Që nga viti 2017 është aplikuar Doracaku i BSNAS-së i vitit 2015. Gjatë vitit 2016, ShKÇAK dhe IEKA kanë përkthyer dhe shpërndarë anëtarëve të tyre SNA-të e reja dhe të rishikuara lidhur me opinionin e auditimit (SNA 700, 701, 705, 706, 720), versionin e botuar nga BSNAS. Nuk ka në dispozicion informacion nëse shoqatat e tjera, profesionale, IKAf dhe AAB, të licencuara nga KKRF, kanë përkthyer ose kanë ndonjë marrëveshje për përkthimin e SNA-ve.	 Rishiko dhe përmirëso	Me standardet e reja të raportimit të auditorit të ri, ShKÇAK inkurajohet të sigurojë që programet Edukimi Fillestar Profesional dhe EVP të përfshijnë kërkesat e reja.

DOA 4 – Kodi i Etikës

Vlerësimi i FNK-së për statusin e përmbushjes së DOA-së në nivel kombëtar	
 Adoptuar	<i>U zbatua një version i vitit 2009 ose më vonë i Kodit të Etikës së BSNEK-së për Profesionistët e Kontabilitetit dhe Auditimit.</i>
 Adoptuar pjesërisht	<i>Nuk janë zbatuar të gjitha kërkesat e versionit të vitit 2009 ose më vonë të Kodit të Etikës së BSNEK-së. ose Kodi i Etikës së BSNEK-së është zbatuar vetëm për disa profesionistë të kontabilitetit dhe auditimit</i>
 Nuk është adoptuar	<i>Nuk është zbatuar një version i vitit 2009 ose më vonë i Kodit të Etikës së BSNEK. ose Është zbatuar versioni i Kodi i BSNEK para vitit 2004.</i>

DOA 4 – Kodi i Etikës

Statusi në nivel kombëtar	Përgjegjësia e OPK-së	Komente nga FNK	Statusi i ShKÇAK-së	Rekomandime
 Adoptuar	E përbashkët	Sipas Ligjit Nr.04 / L-014, Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) kërkon që të gjitha shoqatat profesionale të miratojnë një Kod Etik dhe janë përgjegjës për zbatimin e pajtueshmërisë me kërkesat e tij. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2014, Kriteret për Njohjen e Shoqatave Profesionale të Kontabilitetit/Auditimit i KKRF-së kërkon që Kodi i Etikës të harmonizohet me Kodin e BSNEK. Informacioni mbi zbatimin e Kodit të BSNEK-së nga Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF), dhe Instituti AAB për Kontabilistët e Certifikuar dhe Auditorët (IAAB), të cilat nuk janë organizata anëtare të FNK-së, nuk është në dispozicion.	 Rishiko dhe përmirëso	ShKÇAK inkurajohet të punojë me palët e tjera të interesit në juridiksion për të mandatuar ligjërësht zbatimin e Kodit të BSNEK-së në juridiksion dhe për të sqaruar rolet përkatëse të shoqatave profesionale dhe KKRF-së. ShKÇAK mund të shqyrtojë mënyrat për të eliminuar vonesën ekzistuese në mes të zbatimit të Kodit të Etikës, të ri dhe të rishikuar, dhe përfshirjes së kërkesave më të fundit në juridiksion. Rekomandohet të ndërmerren veprime konkrete për të mbështetur anëtarët e ShKÇAK-së të kuptojnë kërkesat e Kodit si dhe rekomandohet ndërmarrja e veprimeve për të siguruar pajtueshmërinë me Kodin, nëse ka të tillë. Së fundmi, shoqata mund të marrë në konsideratë plane se si të mbështesë zbatimin e kërkesave të NOCLAR.

DOA 5 – Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

	Vlerësimi i FNK-së për statusin e përmbushjes së DOA-së në nivel kombëtar
 Adoptuar	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) me bazë akruale, janë zbatuar si standarde të kontabilitetit për të gjitha entitetet në sektorin publik
 Adoptuar pjesërisht	Nuk janë zbatuar të gjitha SNKSP-të. ose Janë zbatuar SNKSP-të në bazë të parasë së gatshme. ose Janë zbatuar SNKSP-të vetëm për disa entitete të sektorit publik
 Nuk është adoptuar	Nuk janë zbatuar SNKSP-të.

DOA 5 Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP)

Statusi në nivel kombëtar	Përgjegjësia e OPK-së	Komente nga FNK	Statusi i ShKÇAK-së	Rekomandime
 Adoptuar pjesërisht	Jo direkte	Ministria e Financave është përgjegjëse për vendosjen e standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në Kosovë. Rregullat e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) janë në përputhje me kërkesat e BE-së, SNKSP-ve dhe ligjeve vendore. Megjithëse Kosova ishte ndër vendet e para për t'i adoptuar SNKSP-të në bazë të parasë së gatshme në 2004, nuk janë zbatuar SNKSP-të me bazë akruale dhe nuk ndikohen nga ndonjë afat i caktuar kohor për zbatimin e tyre. Është periudhën 2009-2011, ShKÇAK dhe Ministria e Financave krijuan Programin e Trajnimit për Menaxhimin e Financave Publike (MFP). Në nëntor të vitit 2015, ShKÇAK nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Institutin e Financave Publike dhe Kontabilitetit (CIPFA) për një skemë të përbashkët të certifikimit të MFP Një zhvillim tjetër i rëndësishëm ka qenë krijimi i një skeme të re certifikimi për Auditorët e Sektorit Publik të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), në nëntor të vitit 2016, në koordinim me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP). Që nga viti 2017, janë certifikuar 100 auditorë të sektorit publik në Kosovë. Për më tepër, zhvillimi i programit të certifikimit të sektorit publik ka tërhequr interesin e vendeve të tjera në rajon. Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë (ALSAI) dhe ShKÇAK kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi për të zhvilluar një strategji për zbatimin e skemës së certifikimit për auditorët e ALSAI të Shqipërisë	 Qëndro	ShKÇAK inkurajohet të azhurnojë Planin e Veprimit të DOA-së mbi iniciativat specifike të ndërmarra për të nxitur zbatimin e SNKSP-ve në juridiksionin.

DOA 6

DOA 6 – Hetim dhe Disiplinë

	Vlerësimi i FNK-së për statusin e përmbushjes së DOA-së në nivel kombëtar
 Adoptuar	<i>U krijua një sistem i Hetimit dhe Disiplinës (H&D) që përfshin kërkesat për DOA 6 dhe është funksional për të gjithë profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit.</i>
 Adoptuar pjesërisht	<i>U krijua një sistem H&D që përfshin kërkesat për DOA 6 dhe është funksionale për disa profesionistë të kontabilitetit dhe auditimit. ose U krijua një sistem H&D dhe është funksional për të gjithë profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit, por nuk përmbush të gjitha kërkesat e DOA 6. U krijua një sistem H&D që përfshin kërkesat për DOA 6 por nuk është funksional ende.</i>
 Nuk është adoptuar	<i>Nuk është krijuar asnjë sistem H&D.</i>

DOA 6 – Hetim dhe Disiplinë

Statusi në nivel kombëtar	Përgjegjësia e OPK-së	Komente nga FNK	Statusi i ShKÇAK-së	Rekomandime
 Adoptuar pjesërisht	E përbashkët	Ligji Nr.04 / L-014 autorizon Këshillin Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) të vendosë sanksione dhe gjopa për mospërfshirjen me kërkesat e përshkruara në ligj. Për këtë qëllim, në bazë të Udhëzimit Administrativ të KKRF-së Nr. 2012/06 mbi Procedurat e Hetimit dhe Disiplinës, Komisioni për Hetimin dhe Disiplinën i KKRF-së kryen hetime dhe disiplina (H & D) të shoqatave të licencuara, firmave të auditimit dhe auditorëve ligjorë. Nuk është e qartë nëse sistemi me të cilin operon KKRF është në përputhje me kërkesat e DOA 6. Shoqata profesionale e licencuar është përgjegjëse për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi H&D të anëtarëve të tyre, si dhe raportimin në KKRF në lidhje me rezultatet e saj. ShKÇAK, anëtare e FNK, raporton se ka krijuar një sistem të H&D. IKAF duket të ketë një politikë në H&D të anëtarëve të saj megjithatë, nuk është e qartë nëse sistemi është funksional dhe është në përputhje me kërkesat e DOA 6. Nuk ka në dispozicion informacion mbi Institutin AAB, organizatë jo-anëtare e FNK-së	 Planifiko	ShKÇAK inkurajohet të konsiderojë hartimin e një plani për adresimin e boshllëqeve në pajtueshmëri me kërkesat e DOA 6 dhe të inkorporojë atë në Planin e Veprimit të DOA përgjatë raundit të radhës së azhurnimeve. Ata gjithashtu inkurajohen të kryejnë vetëvlerësimin e sistemit të H & D ndaj kërkesave të DOA 6. Rekomandohet gjithashtu që ShKÇAK t'i shpërndajë kërkesat e rishikuara të DOA 6 me akterët e tjerë të përfshirë në hetimin dhe disiplinën e profesionit, si KKRF-ja po ashtu edhe shoqatat e tjera profesionale, në mënyrë që të promovojë pajtueshmërinë në nivelin e juridiksionit dhe të lehtësojë bashkëpunimin në krijimi e një sistemi të unifikuar.

DOA 7

DOA 7 – Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

	Vlerësimi i FNK-së për statusin e përmbushjes së DOA-së në nivel kombëtar
 Adoptuar	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) janë zbatuar dhe aktualisht janë efektive për të gjitha subjektet me interes publik.
 Adoptuar pjesërisht	Nuk janë zbatuar të gjitha SNRF-të. ose SNRF-të janë zbatuar për disa entitete me interes publik.
 Nuk është adoptuar	SNRF-të nuk janë zbatuar

DOA 7 – Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Statusi në nivel kombëtar	Përgjegjësia e OPK-së	Komente nga FNK	Statusi i ShKÇAK-së	Rekomandime
 Adoptuar	Jo direkte	Sipas Nenit 14 të Ligjit Nr. 04 / L-014, kompanitë e mëdha që plotësojnë dy nga tre kriteret e madhësisë duhet të përdorin Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të plota të nxjerra nga BSNK dhe miratuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF). Kompanitë e mesme dhe të vogla mund të përdorin ose SNRF të plotë ose SNRF për NVM-të, të miratuara nga KKRF-ja. Mikro-ndërmarrjet nën kriteret e specifikuar të madhësisë duhet të ndjekin standardet e thjeshtuara të lëshuara nga KKRF-të që janë të bazuara në SNK të cilat ekzistojnë nga viti 2001. Sipas Ligjit, të gjitha kompanitë mund të zgjedhin që të zbatojnë drejtpërdrejt standardet e nxjerra nga BSNK. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) mandaton përdorimin e SNRF-ve të plota për raportimin financiar të bankave dhe kompanive të sigurimeve. KKRF ka një marrëveshje me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit të Shqipërisë (KKKSh) për përdorimin e versionit të përkthyer në shqip të SNRF-ve zyrtare siç publikohen nga BSNK. Që nga viti 2017, po zbatohet botimi i SNRF-ve i vitit 2016.	 Qëndro	



ShikçAK

**RAPORTET NGA
KOMISIONET**



Raport nga Komisioni për Nominime

Të nderuar anëtarë,

Çdo dy vjet, Shoqata kalon nëpër procesin e zgjedhjeve për anëtarë të Këshillit; edhe më shpesh kur bëhen zgjedhjet për anëtarë të komisioneve. Gjatë vitit 2017, Komisioni për Nominime ka filluar përgatitjet për zgjedhjet e vitit 2018, për anëtarë të rinj të Këshillit dhe të Komisionit të Nominimeve.

Duke qenë se Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), ka njoftuar përmes shkresës zyrtare se nuk do ta dërgojë më një anëtar (me automatizëm) në përbërjen e Këshillit të Shoqatës, kanë filluar diskutimet për ndryshimin e Rregullores së Komisionit për Nominime. Rregullorja është plotësuar me disa kritere, të cilat do të merren parasysh nga Komisioni i Nominimeve gjatë procesit të përzgjedhjes, duke fuqizuar kështu intervistimin, si një prej fazave të rëndësishme në përzgjedhjen e anëtarëve të rinj.

Diskutime më të mëdha janë bërë në lidhje me mënyrën e ndërtimit të strukturës së re të Këshillit. Edhe pse Komisioni për Nominime nuk ka dërguar ndonjë propozim final mbi mënyrën e kompozimit të Këshillit të Shoqatës, në takimet e Komisionit janë diskutuar modalitetet e ndryshme për një përfshirje sa më reprezentative të anëtarëve të Shoqatës në Këshill.

Ka pasur propozime që të hiqen sektorët si kriter dhe të përzgjidhen ata anëtarë që fitojnë numrin më të madh të votave. Duke qenë se sipas Rregullores për mbledhjet e përgjithshme të asamblesë është kufizuar mundësia e zgjedhjes së dy apo më shumë kandidatëve nga i njëjti insitucion apo kompani, atëherë propozimi ka qenë që të mos ketë ndarje sipas sektorëve. Përqindja për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të vendoset sipas përqindjes së anëtarëve në bazë të thirrjeve. Vendimmarrja për mënyrën e ndërtimit të strukturës së re të Këshillit do të bëhet gjatë vitit 2018.

Procesi i nominimeve dhe zgjedhjeve për anëtarë të rinj do të përfundojë në qershor të vitit 2018, kur edhe do të prezantohet ky raport.

Jam i bindur se, si gjithnjë e edhe këtë herë, Komisioni me punën e tij do të paraqesë dhe reflektojë kontributin dhe pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve në një proces të rëndësishëm për mbarëvajtjen e Shoqatës-procesin zgjedhor.

Urime për të zgjedhurit dhe suksese në angazhimin e tyre për të mirën e Shoqatës.

Nazmi Pllana

Kryesues i Komisionit për Nominime

KOMISIONI PËR NOMINIME



*Nga e majta: Fahri Breznica, Nazmi Pllana, Tomorr Zhaveli, Burim Zagragja, Shaban Muharremi
Mungojnë: Adrian Alo, Naim Avdiu*



Raport nga Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë

Të nderuar anëtarë,

Njëri nga qëllimet bazuar në statutin e Shoqatës është përfaqësimi i profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Republikën e Kosovës, dhe udhëzimi i anëtarëve të saj të veprojnë në përputhje me Kodin e Etikës të FNK-së.

Konsiderojmë se anëtarët e Shoqatës, gjatë ballafaqimit me çështjet etike kanë treguar maturi dhe kujdes të veçantë, që kjo çështje të jetë primare duke respektuar të gjitha parimet etike dhe rregullat e mirësjelljes.

Kjo dëshmon faktin se gjatë viteve të kaluara dhe gjatë këtijë viti, ne si Komision për Sjellje dhe Disiplinë nuk kemi trajtuar raste që kanë qenë në kundërshtim me çështje etike, me ç'rast, shprehim mirënjohje të gjithë anëtarëve për profesionalizimin e tyre të treguar deri më tani dhe besojmë se ky profesionalizëm do të vazhdojë dhe më tutje.

Gjithashtu, me kërkesë të anëtarëve të Komisionit është propozuar ndryshimi, përkatësisht ridefinimi i disa prej pikave të rregullores së Komisionit. Një gjë e tillë është realizuar dhe rregullorja në fjalë pritet të aprovohet nga Këshilli i Shoqatës.

Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë është angazhuar të informojë në vazhdimësi anëtarët rreth të rejave të çështjeve etike, çështje e ndjeshme cila duhet të monitorohet në vazhdimësi.

Poashtu objektivë e Komisionit vazhdon të mbetet edhe bashkëpunimi me komisionet tjera të ngjashme brenda dhe jashtë Shoqatës, në fukcion të mbrojtjes së interesit publik në tërësi, përkatësisht interesave të Shoqatës si pjesë integruese.

Respektimi i parimeve themelore të Kodit të Etikës është obligim i çdo anëtari përderisa shkelja e këtyre parimeve sjellë pasoja të dëmshme jo vetëm për anëtarët, por edhe për Shoqatën dhe mbi të gjitha për interesin publik për mbrojtjen e të cilit angazhohet SHKÇAK.

Komisioni për Hetim dhe Disiplinë e shprehë gatishmërinë për trajtimin e rasteve në mënyrë te paanshme dhe iu bën thirrje të gjithë anëtarëve si dhe komunitetit në përgjithësi, që të paraqesin çdo rast të veprimeve që mund të jenë të dëmshme dhe që mund ta cenojnë integritetin profesional.

Arlind Sadrija

Kryesues i Komisionit për
Sjellje dhe Disiplinë

KOMISIONI PËR SJELLJE DHE DISIPLINË



Nga e majta: Arlind Sadrija, Aurora Sinanaj-Dinaj, Nazmi Sahitaj, Yll Fondaj



Raport nga Komisioni për Edukim Profesional

Të nderuar anëtarë,

Në një mjedis çdo herë e më shumë kompleks, inovativ dhe ndryshues kërkesa për profesionistë në kontabilitet dhe auditim do të jetë çdo herë e më shumë në rritje. Komisioni për Edukim Profesional i ShKÇAK-së duke i parë këto ndryshime, për të përgatitur anëtarët ekzistues dhe ata të rinj, është siguruar që në Shoqatë të ofrohen programe certifikuese të cilat në vazhdimësi ofrojnë aftësi të shumta teknike me qëllim të zhvillimit të shkathtësive analitike, komunikative, të menaxhmentit, teknologjisë informative, ndërpersonale etj. Përherë, duke e mbajtur hapin me këtë, janë zhvilluar programe të certifikimit të cilat janë të bazuara në sisteme që përshtaten në mënyrë të duhur me edukimin universitar në njërën anë dhe me kërkesat e tregut dhe të bizneseve në anën tjetër, duke krijuar kështu profesionistë kompetentë, me sjellje etike dhe me reputacion në të gjitha sferat.

Në vitin 2017 Shoqata ka filluar me implementimin e programit të ri certifikues për auditor të brendshëm, duke filluar kështu me trajnimet dhe provimet për kandidatët e rinj në lëmin e auditimit të brendshëm. Për mos t'u ndalur vetëm me këtë, gjatë vitit 2017 janë zhvilluar edhe dy programe të reja certifikuese, programi për Ekspertë të Licensuar të Forenzikës Financiare dhe programi për Ekspertë Tatimorë.

Për të dy këto programe Komisioni, në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit dhe Standardeve Profesionale nga Zyra Ekzekutive kanë punuar ngushtë për të përgatitur dokumentacionin për akreditim në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK). Pritet që gjatë vitit të ardhshëm të merret akreditimi për të dy programet.

Me qenë se Shoqata ka krijuar një diversitet të programeve certifikuese për t'i plotësuar kërkesat për profesionistë në të gjitha sferat, ka lindur nevoja që të përgatiten dhe të rishikohen edhe kërkesat për përvojat praktike për këto programe. Zhvillimi i kompetencave të nevojshme nga punëdhënësit përmes përvojës praktike me cilësi të lartë është gjithashtu thelbësore. Në këtë drejtim, janë përcaktuar kompetencat teknike të nevojshme për t'u plotësuar nga kandidatët për të fituar titujt në programin e auditimit të brendshëm, sektorit publik si dhe janë rishikuar ato të sektorit privat.

Komisioni për Edukim Profesional ka përgjegjësi për ta këshilluar Këshillin e ShKÇAK-së mbi politikat lidhur me të gjitha aspektet e programit të edukimit profesional dhe të ofrojë mbikëqyrje dhe asistencë në punën e Departamentit të Edukimit dhe Standarde Profesionale lidhur me EVP-në.

Duke u nisur nga fakti se Shoqata paraqet një urë lidhëse mes trendeve globale profesionale dhe anëtarëve të saj, mjeti më i mirë për të krijuar këtë lidhje është nëpërmjet sesioneve të EVP-së. Shoqata ka synim sigurimin e një llojllojshmërie të këtyre sesioneve në lëmin e raportimit financiar, auditimit dhe tatimeve, andaj Komisioni për Edukim Profesional është kujdesur që edhe këtë vit të përcaktohet plani i EVP-së për vitin pasues, si dhe të sigurohet implementimi i këtij plani. Gjatë përgatitjes së planit të EVP-së çdo herë ky Komision ka parasysh kërkesat e anëtarësisë të drejtuara në Departamentin e Shërbimit për Anëtarë dhe përmes anketimit online, si dhe nevojave të tregut dhe kërkesave për përmirësimin e mjedisit të raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë.

Me qenë se përgjegjësi e Komisionit të Edukimit Profesional është përcjellja e zhvillimeve në fushën e edukimit, Komisioni do të

bëjë formulimin e përgjigjeve ndaj propozimeve të FNK-së në fushën e edukimit profesional dhe do të mbajë lidhje me organizatat relevante në Kosovë, në BE dhe ato mbarëkombëtare, për të siguruar që programi i ShKÇAK-së të mbetet i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës dhe i njohur edhe jashtë Kosovës.

Përfundimisht, Komisioni për Edukim Profesional do të monitorojë zbatimin e kërkesave profesionale të BSNEK-së për kualifikimet për Teknikë të Kontabilitetit, Kontabilistë të Çertifikuar, Auditorë të Çertifikuar, Auditorë të Brendshëm të Çertifikuar, Auditorë të Çertifikuar të Sektorit Publik si dhe do të mbikëqyrë në vazhdimësi zhvillimin e kuadrove profesionale në të gjitha sferat dhe mbetemi të përkushtuar që të jemi në shërbim jo vetëm të anëtarësisë, por edhe të interesit publik në përgjithësi.

Naim Avdiu

Kryesues i Komisionit për Edukim Profesional

KOMISIONI PËR EDUKIM PROFESIONAL



Nga e majta: Riza Spanca, Edona Perjuci-Uka, Lulzim Zeka
Mungojnë: Naim Avdiu, Visar Peci



Raport nga Nënkomisioni për Tatime

Të nderuar anëtarë,

Nënkomisioni për Tatime është pjesë e Komisionit të Edukimit Profesional pranë ShKÇAK-së. Ky nënkomsion është përgjegjës të veprave sipas Rregullores së Nënkomisionit për Tatime të aprovuar nga Këshilli i ShKÇAK-së.

Gjatë vitit 2017, Shoqata është përfaqësuar në takimet e Komitetit Tatimor të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), që kanë të bëjnë me tatime. Në fund të shtatorit është mbajtur takimi i Nënkomisionit për Tatime ku është përzgjedhur kryesuesi. Poashtu, në këtë takim është hartuar edhe Plani i Punës në detaje për vitin 2017-2018 i paraparë me Rregulloren e Nënkomisionit. Në planin e punës janë paraparë aktivitete që kanë të bëjnë me çështje të interesit për anëtarësi.

Duke marrë parasysh vërejtjet që janë marrë nga anëtarësia, është hartuar një listë fillestare e çështjeve që do të përgatitet në formë të një ankete e cila do të përcillet te anëtarësia për të dhënë opinionin dhe përvojën e tyre në shumë segmente në raport me çështjet që kanë të bëjnë me trajtimet nga autoritetet tatimore.

Çështjet fillestare të aprovuara nga Nënkomisioni që do të trajtohen në këtë anketë kanë të bëjnë me fushën e edukimit dhe interpretimeve nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), praktikën e trajtimeve të çështjeve të ndryshme në rivlerësime tatimore, ankesa si dhe çështjet në nivele tjera siç janë aktgjykimet nga gjykatat. Tërë këto informata, pas anketës do të përdoren për diskutime me ATK-në, duke mos marrë përgjegjësi ligjore për raste individuale.

Është planifikuar që çështjet e ndryshme të interesit të diskutohen përmes forumit online që ka filluar në dhjetor 2017 duke filluar nga aplikimi i ngarkesës së kundërt ku anëtarët e Shoqatës kanë pasur paqartësi si pasojë e ndryshimeve të shumta të akteve nënligjore nga vetë Ministria e Financave.

Gjatë periudhës raportuese, Shoqata është përfaqësuar në takimet e Komitetit të Tatimeve në OEAK, në diskutimet e temave të rëndësishme si lehtësirat tatimore për bizneset e reja të paraparë me ligjin për tatimin në të ardhura të korporatave dhe ligjin për tatimin në të ardhura personale.

Këtu ishte përfshirë edhe kërkesa për trajtime të ngarkesës së kundërt për shërbimet jashtë vendit, që si rrejdhojë ka rezultuar me nxjerrjen e aktit nënligjor nga ATK për këtë çështje.

Përfaqësuesit e Shoqatës në emër të Nënkomisionit kanë kërkuar dhe arsyetuar që Ministria e Financave ta marrë parasysh që për shkak të vonesave në trajtimin e lëndëve në gjykata, kërkesën që Bordi për rishqyrtime tatimore të kthehet në veprim, në mënyrë që bizneset të mos mbesin peng i vonesave me vite të shqyrtimit të ankesave pas vendimeve përfundimtare të ATK-së.

Me planin e vitit 2018 synohet që Nënkomisioni për Tatime të ndihmojë anëtarësinë me çështjet e interesit për të lehtësuar punën në shërbimet e tyre me interes publik, përfshirë edhe diskutimet përmes forumit online dhe anketave.

Fahri Breznica
Kryesues i Nënkomisionit për Tatime

NËNKOMISIONI PËR TATIME



Nga e majta: Tomorr Zhaveli, Fahri Breznica, Xhemail Sylja, Burim Zagragja, Arbër Hoti
Mungon: Sakip Imeri



Raport nga Komisioni për Sigurim të Cilësisë

Të nderuar anëtarë,

Qëllimi kryesor i Komisionit dhe Departamentit të Sigurimit të Cilësisë gjatë vitit 2017 ishte implementimi i Rregullores së Kontrollit të Cilësisë, përpilimi i letrave të punës të cilat do të shfrytëzohen gjatë procesit të kontrollit të cilësisë, përzgjedhja e auditorëve dhe angazhimeve të auditimit për kontroll të cilësisë, si dhe hulumtimi i cilësisë së pasqyrave financiare të audituara dhe opinioneve të auditimit, gjithnjë duke u bazuar në planin strategjik dhe planin e punës së ShKÇAK-së.

Në këtë drejtim si prioritet tjetër i këtij komisioni dhe Departamentit të Sigurimit të Cilësisë, gjatë vitit 2017 ishte edhe bashkëpunimi i ndërsjellë me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë të KKRF-së për të rishikuar mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy komisioneve në mënyrë që mbikëqyrja publike e auditorëve dhe firmave të ligjore të auditimit të jetë sa më efikase dhe efektive dhe të prodhojë rezultate konkrete në ngritjen e cilësisë së këtij profesioni.

Duke u bazuar në faktin që auditorët ligjorë dhe firmat ligjore të auditimit janë profesionistë të pavarur, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe duke vlerësuar rolin dhe kontributin e tyre në mbrojtje të interesit publik, nëpërmjet zbatimit të drejtë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe

respektimit të kërkesave të cilat dalin nga Kodi i Etikës për Auditorët Profesionistë të FNK-së, Departamenti i Sigurimit të Cilësisë gjatë vitit 2017-të filloi implementimin e rregullorës së kontrollit të cilësisë së punës së auditorëve. Kjo rregullore është shfrytëzuar si udhërrëfyes për një implementim sa më efektiv të sistemit të sigurimit të cilësisë nga ana e ShKÇAK-së.

Gjithashtu, Komisioni aprovoi raportet e vlerësimit lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet që Departamenti i Sigurimit të Cilësisë i identifikoi gjatë kryerjes së kontrollit të angazhimeve.

Gjithashtu, Komisioni aprovoi raportet e vlerësimit lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet që Departamenti i Sigurimit të Cilësisë i identifikoi gjatë kryerjes së kontrollit të angazhimeve.

Viti 2018 do të jetë një vit i zhvillimeve më intensive në aspektin e sigurimit të cilësisë. Departamenti i Sigurimit të Cilësisë do të vazhdojë mbajtjen e takimeve me auditorë ligjorë dhe rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimeve të auditimit. Duke u bazuar në të gjeturat gjatë kontrollit të cilësisë do të propozohen EVP të cilat do të kenë për qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve të auditimit.

Gjithashtu do të publikohet raporti me të gjeturat e përgjithshme gjatë kontrollit të cilësisë, si dhe do të vazhdohet të rishikohet cilësisia e pasqyrave financiare të audituara të ndërmarrjeve të mëdha, të cilat kanë pasur obligim dorëzimin e tyre për publikim në KKRF. Raporti i hulumtimit të cilësisë së pasqyrave financiare pas aprovimit nga Këshilli i ShKÇAK do të publikohet.

Në fund, më lejoni të falënderoj Departamentin e Sigurimit të Cilësisë për punën e realizuar gjatë vitit 2017 në fushën e kontrollit të cilësisë, duke kontribuar kështu në realizimin e misionit të ShKÇAK për mbrojtje të interesit publik.

Lekë Musa

Kryesues i Komisionit për Sigurim të Cilësisë

KOMISIONI PËR SIGURIM TË CILËSISË



Nga e majta: Fahri Breznica, Shpresa Mustafa, Lekë Musa, Ardiana Bunjaku, Mentor Hyseni
Mungon: Naim Avdiu



Raport nga Komisioni për Standarde Profesionale

Të nderuar anëtarë,

Komisioni për Standarde Profesionale ka përgjegjësi dhe kompetencë për t'i përcjellur zhvillimet në fushën e raportimit financiar dhe auditimit në nivel global. Komisioni diskuton tema të rëndësishme që ndërlidhen me të gjitha ndryshimet e Standardeve Profesionale dhe informon rregullisht anëtarësinë për ndikimin dhe implemtimin e këtyre ndryshimeve.

Nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të tij, Komisioni ka kontribuar dhe vazhdon të kontribojë edhe në projektet që inicohen për plotësim ndryshime të rregullativës qoftë ligjore apo standardeve përkatëse, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Këtë përgjegjësi, Komisioni e përmbush duke diskutuar dhe shqyrtuar propozimet dhe duke vlerësuar kontributin e atyre përmirësimeve në krijimin e ambientit rregullativ më të qëndrueshëm në fushën e raportimit financiar dhe të auditimit.

Komisioni ka pasur kënaqësi të veçantë të kontribuojë në shqyrtimin dhe njëherit të jepë komente dhe propozime në lidhje me përkufizimin dhe mbrojtjen e interes publik, mënyrën e nominimeve të anëtarëve të Komiteteve të ndryshme të FNK-së.

Ndryshimet e shpejta të teknologjisë së informacionit, po ndikojnë jo vetëm në mënyrën e përpunimit të informacioneve financiare, por edhe të publikimit të tyre në platformë elektronike, në formate specifike, dhe kontrollit – auditimit të raporteve financiare. Kjo po ngritë një mori çështjesh me të cilat anëtarët po detyrohen të ballafaqohen. Prandaj Komisioni për Standarde, me aktivitetin e vet që po e zhvillon, thekson në mënyrë të veçantë nevojën e avancimit të vazhdueshëm me qëllim jo vetëm t'u bëjë ballë të gjitha këtyre ndryshimeve, por që ta rrisë nivelin e kompetencës profesionale të anëtarësisë e sidomos në përmbushjen e objektivit parësor të ruajtjes së interes publik.

Prandaj, Komisioni vazhdon të jetë i përkushtuar në zhvillimin dhe avancimin e standardeve profesionale në fushën e raportimit financiar dhe të auditimit.

Bekim Berisha

Kryesues i Komisionit për Standarde Profesionale

KOMISIONI PËR STANDARDE PROFESIONALE



*Nga e majta: Alban Lufi, Arbër Hoti, Bekim Berisha, Nazmi Pllana, Xhevdet Beqiri
Mungojnë: Adrian Alo, Jan Tyl, Lulzim Berisha, Teuta Ukshini*

Statistikat e vitit **2017**




Statistikat e vitit 2017

Llojet e shërbimeve që ofrohen nga anëtarët e ShKÇAK-së

Shërbimet e auditimit, shërbimet e kontabilitetit, këshillimet për tatime, dhe role të tjera të ngjashme, janë disa nga shërbimet tipike që ofrohen prej kontabilistëve të punësuar në ekonominë perëndimore, e që kryhen edhe nga anëtarët e ShKÇAK-së.

Grafiku i mëposhtëm e paraqet shpërndarjen e anëtareve tanë të cilët janë profesionistë të kontabilitetit dhe auditimit nëpër sektorë të ndryshëm, duke demonstruar se profesionistë të tillë janë të përfaqësuar në një gamë të gjerë të sektorëve të punës. Prandaj, ngritja e kapaciteteve në këtë profesion është e domosdoshme në mënyrë që të gjithë sektorët të operojnë me cilësi të lartë. Pikërisht kjo është ajo që e motivon ShKÇAK-në për të krijuar programe të reja për specializim në sektorë specifike, pra në atë privat dhe publik si dhe fusha specifike siç është auditimi i brendshëm.

PËRQINDJA E ANËTARËVE AKTIVË TË PUNËSUAR NËPËR SEKTORË



Rezultatet tregojnë se 37% e anëtarëve janë të punësuar në kategorinë Biznes/Industri, ndërsa 13% e tyre janë të punësuar në sektorin publik. Po ashtu, 13% e tyre janë partnerë apo punonjës në firma të auditimit dhe kontabilitetit, 20% janë studentë dhe 16% e anëtarëve janë të angazhuar në sektorë të tjerë.


Një numër i konsiderueshëm i anëtarëve tanë janë po ashtu të përfshirë në sektorin Akademi/Edukim, përkatësisht 1.01% e tyre. Ky përfaqësim ndihmon në përafrimin e kurrikuleve të kontabilitetit dhe auditimit në mes të edukimit akademik dhe profesional sipas Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit në kontabilitet (SNE).

Studentët e regjistruar gjatë vitit 2017

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e studentëve të rinj, të cilët janë regjistruar në programet çertifikuese të ShKÇAK-së. Siç mund të shihet, është treguar një interesim mjaft i madh nga studentët për programet e reja të Shoqatës në fushën e Forenzikës Financiare dhe Auditimit të Brendshëm.

Specifikisht, 51 studentë janë regjistruar në programin për titullin Ekspert i Forenzikës Financiare dhe 92 studentë janë regjistruar në programin për të marrë titullin Auditor i Brendshëm i Çertifikuar.

NUMRI I STUDENTËVE TË RI SIPAS PROGRAMEVE ÇERTIFIKUESE




Thirrjet e fituara përgjatë viteve

ShKÇAK iu jep studentëve dhe anëtarëve mundësi mjaft të mëdha për t'u treguar të suksesshëm duke ofruar tre afate të provimeve gjatë një viti. Në këtë mënyrë edhe atëherë kur studentët dhe anëtarët nuk arrijnë suksesin e dëshiruar gjatë një afati mund të përgatiten dhe të kenë mundësinë t'i nënshtrohen provimeve një apo dy afate më vonë.

Statistikat e ShKÇAK-së flasin për një rritje të theksuar të numrit të anëtarëve të çertifikuar nga viti 2014-2017, në të tre nivelet e çertifikimeve, ku vërehet një interesim i shtuar për pjesëmarrje në nivelet Teknik i Kontabilitetit, Kontabilist i Çertifikuar dhe Auditor i Çertifikuar.

ANËTARËT QË KANË FITUAR THIRRJEN PËRKATËSE




Pjesëmarrja në profesion sipas gjinisë

Tradicionalisht, profesioni i kontabilitetit dhe auditimit ka qenë i përfaqësuar nga meshkujt si në botë ashtu edhe në vend. Megjithatë, në kohët e fundit ka pasur një ndryshim për të mire në këtë drejtim pasi që ka vazhduar të rritet numri i ushtrueseve femra të këtij profesioni. Kjo e përforcon faktin që femrat në Kosovë po fuqizohen në profesion dita ditës më shumë.

Grafiku i mëposhtëm tregon se gjate vitit 2017, përqindja e anëtareve femra të Shoqatës ka qenë 51%, ndërsa e anëtarëve meshkuj ka qenë 49%. Kështu, krahasuar me vitin 2002 ku pjesëmarrja e femrave si anëtare të shoqatës ka qenë vetëm 14%, viti 2017 shënon rritje me pjesëmarrje të femrave.

ANËTARËT AKTIVË TË SHOQATËS SIPAS GJINISË




Interesimi i të rinjve për profesionin

Përfaqësimi i anëtarëve aktivë të ShKÇAK-së sipas moshës është i paraqitur në grafikun e mëposhtëm ku i krahasojmë vitet 2014 -2017.

Në kategorinë nën 25-34 vjeç, përqindja e anëtarëve është rritur nga 67% në 69%. Kjo nënkupton se të rinjtë në Kosovë janë të interesuar të kualifikohen çdo herë e më shumë në kontabilitet dhe auditim duke marrë parasysh përfitimet që sjellë profilizimi në një fushë specifike.

Gjithashtu edhe në dy kategoritë tjera (35 -54 vjeç dhe mbi 55 vjeç) përfaqësimi është mjaft i madh dhe dallimi në mes të anëtarëve aktivë të këtyre grup-moshave për vitet e cekura.



Çelësi i
suksesit të
ShKÇAK është
anëtar i saj



Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur
31 Dhjetor 2017

Përmbajtja:

Raporti i auditorëve të pavarur	3
Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse	6
Pasqyra e pozitës financiare	7
Pasqyra e ndryshimeve në fonde	8
Pasqyra e rrjedhës së parasë	9
Shënimet e pasqyrave financiare	10-29

Raport i Auditorit të Pavarur

Drejtuar: Këshillit të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Opinion pa rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (tutje referohet si "Organizata" apo "ShKÇAK") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2017, pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq. 6-23.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës më 31 dhjetor 2017, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Baza për opinion pa rezervë

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tone më sipër, dhe ne nuk do të japin një opinion të veçantë mbi këto çështje.

Ne kemi vendosur se nuk ka çështje të rëndësishme të auditimit për të komunikuar në raportin tonë.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritjet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.



- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto,

Ymer Shatri
Partner Angazhimi
28 Mars 2018




Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

(në Euro)
Viti i përfunduar me 31 Dhjetor

	Shënimet	2017	2016
Të hyrat operative			
Të hyrat nga edukimi	3	329,284	317,235
Të hyrat nga anëtarësimi	3	105,526	122,115
Të hyrat nga kontrolli i cilësisë	3	6,200	4,800
Të hyrat tjera	3	5,531	7,450
Të hyrat nga BQK	3		5,788
Të hyrat nga forumi	3		10,300
		446,541	467,688
Shpenzimet			
Shpenzimet administrative	4	161,764	151,264
Shpenzimet e trajnimit	5	153,858	163,441
Shpenzimet e provimeve	6	23,334	23,510
Shërbimet për anëtarë	7	127,665	136,291
		466,621	474,506
Teprica (deficiti) e akumuluar e të hyrave		(20,080)	(6,818)

Ermal Kozgori

Udhëheqës i financave



Nazmi Pllana

Kryetari i Këshillit



Pasqyra e pozitës financiare


(në Euro)
Viti i përfunduar me 31 Dhjetor

	Shënimet	2017	2016
Pasuritë qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentet e parashë	8	449,459	490,163
Parapagimet	9	5,629	4,837
Të arkëtueshmet	10	3,676	5,662
Të arkëtueshmet e grantit BQK		50	50
Stoqet - librat		4,175	3,675
		462,989	504,387
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe paisjet	11	5,927	6,034
Pasuritë e paprekshme	12	29,908	37,091
		35,835	43,125
Totali i pasurive		498,824	547,512
Detyrimet afat-shkurta			
Detyrimet tregtare dhe të tjera	13	10,537	17,641
Të hyrat e shtyra	14	93,727	115,231
		104,264	132,872
Fondet			
Teprica e akumuluar e të hyrave		394,560	414,640
		394,560	414,640
Totali i detyrimeve dhe fondeve		498,824	547,512

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i ShKÇAK më 22 Shkurt 2018 dhe janë nënshkruar nga,


Ermal Kozgori

Udhëheqës i financave



Nazmi Pllana

Kryetar i Këshillit



Pasqyra e Ndryshimeve në Fonde

	Me 31 Dhjetor 2017	(në Euro) Me 31 Dhjetor 2016
Me 01 Janar	414,640	421,458
Teprica (suficiti) e të hyrave për vitin	(20,080)	(6,818)
Teprica e akumuluar e të hyrave Me 31 Dhjetor	394,560	414,640

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

(në Euro)
Viti i përfunduar me 31 Dhjetor

	Shënimet	2017	2016
AKTIVITETET OPERATIVE			
Fitimi / (humbja) e vitit		(20,080)	(6,818)
Zhvierësimi dhe amortizimi		12,565	4,599
Të arkëtueshmet		1,985	(2,699)
Parapagimet		(791)	(4,838)
Stoqet – librat		(501)	(3,675)
Detyrimet tregëtare dhe të tjera		(7,103)	3,702
Të hyra të shtyra		(21,504)	37,511
Paraja neto nga aktivitetet operative		(35,429)	27,783
AKTIVITETET INVESTUESE			
Blerja e pajisjeve		(3,987)	(2,028)
Pasurite e paprekshme		(1,288)	(36,861)
Paraja neto nga aktivitetet investuese		(5,275)	(38,889)
AKTIVITETET FINANCUESE		-	-
Rrjedha neto e parasë për periudhën		(40,704)	(11,106)
Gjendja e parasë në fillim		490,163	501,269
Gjendja e parasë në fund	8	449,459	490,163

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

1. Të përgjithshme

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës ("SHKÇAK" ose "Organizata") është organizatë jo profitabile e themeluar në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/22 dhe Ligji Nr.03/L- 134 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare. SHKÇAK është themeluar për qëllim të:

Profesionalizmit të Ndërsjelltë: për të përkrahur, mbrojtur dhe avancuar karakterin, statusin dhe interesat e profesionit të kontabilitetit në përgjithësi dhe të kontabilistëve e auditorëve në veqanti që janë anëtarë të SHKÇAK;

- Rritjes Profesionale: që të lehtësojë mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kompetencave të anëtarëve përgjatë karrierës së tyre;
- Integritetit: për të mbajtur nivelin më të lartë të standardeve profesionale dhe integritetit të anëtarëve në interes të komunitetit; dhe
- Përfaqësimit: për të përfaqësuar profesionin në komunitet.

Me 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Organizata ka kryer aktivitetet me 17 dhe 16 të punësuar përkatësisht.

2 Politikat e kontabilitetit

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit që janë adoptuar në përgatitjen e këtyra pasqyrave financiare:

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet e Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të paraqitura në këto pasqyra financiare janë shprehur në Euro.

2.2 Valuta funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

2.3 Zbatimi i standardeve të reja dhe të ndryshuara

Në vitin aktual, Organizata ka zbatuar një numër të ndryshimeve në SNRF të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë të obligueshme dhe efektive për periudhën që fillon me ose pas datës 1 janar 2017.

Ndryshimet në SNK 1 Iniciativa e shpalosjeve

Organizata ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet qartësojnë se entiteti nuk ka nevojë të ofrojë shpalosje specifike të kërkuar nga SNRF nëse informata rezultuese nga shpalosja nuk është materiale dhe ofron udhëzime për bazën e agregimit dhe disagregimit të informatave për qëllime të shpalosjes. Mirëpo, ndryshimet ritheksojnë se entiteti duhet të konsideroj ofrimin e shpalosjeve shtesë kur pajtueshmëria me kërkesën specifike në SNRF është e pamjaftueshme për të mundësuar përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë ndikimin e transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve specifike mbi pozitën financiare dhe performancën financiare të entitetit.

Sa i përket strukturës së pasqyrave financiare, ndryshimet ofrojnë shembuj të rradhitjes ose grupimit sistematik të shënimeve.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka rezultuar më ndonjë ndikim në performancën financiare ose pozitën financiare të Organizatës.

Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 Qartësimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit

Organizata ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet në SNK 16 ndalojnë entitetet të përdorin zhvlerësimin e bazuar në të hyra si metodë të zhvlerësimit për zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve. Ndryshimet në SNK 38 paraqesin supozime të kundërshtueshme se të hyrat nuk janë bazë e duhur për amortizimin e një pasurie të patrupëzuar. Ky supozim mund të kundërshtohet në dy rrethanat e kufizuara në vijim.

- a) Kur pasuria e patrupëzuara është shprehur si masë e të hyrave; ose
- b) Kur mund të demonstrohet se të hyrat dhe konsumimi i përfitimit ekonomik i pasurisë së patrupëzuar janë në një korelacion të lartë.

Pasi që Organizata tashmë përdor metodën drejtëvizore të zhvlerësimit dhe amortizimit për pasuritë joqarkuluese dhe pasuritë e patrupëzuara përkatësisht, zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Organizatës.

Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 Bujqësia: Bimët bartëse

Organizata ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimet përkufizojnë bimët bartëse dhe kërkojnë që pasuritë biologjike që përmbushin përkufizimin e një bime bartëse të trajtohet si pronë, impiant dhe pajisje në pajtueshmëri me SNK 16, në vend të SNK 41. Frytet që rriten në bimët bartëse vazhdojnë të trajtohen në pajtueshmëri me SNK 41.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të organizatës pasi që organizata nuk është përfshirë në aktivitete bujqësore.

Përmirësimet vjetore në Ciklin 2012-2014 të SNRF

Organizata ka zbatuar këto ndryshime për herë të parë në vitin aktual. Përmirësimet vjetore në ciklin 2012-2014 të SNRF përfshijnë një numër të ndryshimeve në SNRF të ndryshme, të cilat janë përmblodhur më poshtë.

Ndryshimet në SNRF 5 paraqesin udhëzime specifike në SNRF 5 për entitetet që riklasifikojnë një pasuri (ose grup të shlyerjes) nga ajo që mbahet për shitje në pasuri të mbajtur për shpërndarje të pronarët (ose e kundërta). Ndryshimet qartësojnë se një ndryshim i tillë duhet të konsiderohet si vazhdimësi e planit origjinal të shlyerjes/shitjes prandaj kërkesat e paraqitura në SNRF 5 lidhur me ndryshimin e planit të shitjes nuk zbtohen. Ndryshimet po ashtu qartësojnë udhëzimet se kur ndërpritet kontabilitetit i mbajtjes për shpërndarje.

Ndryshimet në SNRF 7 ofrojnë udhëzime shtesë për të qartësuar nëse një kontratë e shërbimeve është përfshirje e vazhdueshme në një pasuri të transferuar për qëllim të shpalosjeve të kërkuara lidhur me pasuritë e transferuara.

Ndryshimet në SNK 19 qartësojnë se norma e përdorur e skontimit të obligimeve pas-punësimit duhet të përcaktohet duke iu referuar rendimentit të tregut në fund të periudhës së raportimit në bono korporative të cilësisë së lartë. Vlerësimi i thellësisë së tregut për bono të cilësisë së lartë duhet të jetë në nivelin e valutës (dmth në valutën e njëjtë në të cilën do të paguhen përfitimet). Për valutat për të cilat nuk ka treg të thellë në bono të tilla korporative me cilësi të lartë, duhet të përdoret rendimenti i tregut në fund të periudhës raportuese për bonot qeveritare të denominuara në atë valutë.

Zbatimi i këyre ndryshimeve nuk ka pasur efekt në pasqyrat financiare të organizatës.

2.3.1 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese të cilat nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese janë publikuar nga BSNK të cilat nuk janë ende efektive dhe nuk janë adoptuar nga Organizata. Informatat për ndryshimet që pritet të jenë relevante për Kompaninë, janë paraqitur më poshtë.

Menaxhmenti pret se të gjitha publikimet do të adoptohen në politikat kontabël të organizatës për periudhën e parë që fillon pas datës efektive të publikimeve. Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që nuk janë adoptuar ose nuk janë listuar më poshtë nuk pritet të kenë efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

SNRF 9 Instrumentet financiare

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime domethënëse në udhëzimet e SNK 39 për riklasifikimin dhe matjen e pasurive financiare dhe paraqet modelin e ri të 'humbjes së pritur kreditore' për dëmtimin e pasurive financiare. SNRF 9 po ashtu ofron ushëzime të reja mbi zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Menaxhmenti ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9 por nuk është ende në pozitë të ofrojnë informata të kuantifikuara.

SNRF 9 është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me konsumatorët

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të hyrave, duke zëvendësuar SNK 18 'Të hyrat', SNK 11 'Kontratat ndërtimore' dhe disa interpretime që lidhen me të hyrat. Parimi themelor i SNRF 15 është që entiteti duhet të njoh të hyrat ashtu që ilustron transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara te konsumatorët në shumën që reflekton konsideratën për të cilën entiteti ka të drejtën si shkëmbim për ato mallra ose shërbime.

SNRF 15 është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

SNRF 16 Lizingu

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretime përkatëse. SNRF 16 paraqet model gjithëpërfshirës për identifikimin e arranzhimeve për lizing dhe trajtimin kontabël për qiradhënësit dhe qiramarrësit. SNRF 16 bën dallimin në mes të kontratave për shërbime duke u bazuar në faktin nëse një pasuri e identifikuar kontrollohet nga konsumatori. Dallimet në mes të lizingut operativ (jasht bilancit) dhe lizingut financiar (në bilanc) janë hequr për kontabilitetin e qiramarrësit dhe është zëvendësuar me modelin sipas të cilit e drejta e përdorimit të pasurisë dhe detyrimi korrespondues duhet të njihen për të gjitha lizingjet nga qiramarrësi (dmth të gjitha në bilanc) përveç për lizingjet afatshkurta dhe lizingjet për pasuritë me vlerë të ulët.

SNRF është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019. Menaxhmenti ende pritet të vlerësojë në tërësi ndikimin e këtij standardi prandaj nuk është në gjendje të ofroj informata të kuantifikuara.

2.4 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë balancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

2.5 Shkëmbimet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje

2.6 Kundërbalancimi (offsetting)

Pasuritë financiare dhe detyrimet janë kundërbalancuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes atëherë kur ka të drejtë të imponueshme ligjore për të kundërbalancuar shumat e njohura dhe ka synim të vendoset në baza neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

2.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Organizatë dhe këto benefite të mund të maten besueshëm.

Organizata njih të ardhurat duke i ngarkuar llojet në vazhdim

Tarifat e anëtarisë dhe tarifat e edukimit janë njohur fillimisht kur është lëshuar fatura. Të hyrat janë rregulluar në fund të vitit për të reflektuar vetëm të hyrat e fituara gjatë vitit.

- Të hyrat nga tarifat e edukimit dhe anëtarimit janë shtyrë për pagesat e pranuar për paradhënie.

2.8 Prona, impiantet dhe paisjet

Prona, impiantet dhe paisjet janë bartur në kosto historike minus zhvlersimi i akumuluar. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zëri.

Zhvlersimi është ngarkuar duke përdorur metodën e bilancit zbritës në normat e paracaktuara në mënyrë që të alokohet kostoja e pronës, impianteve dhe paisjeve përgjatë jetës së tyre të përdorimit. Në vazhdim është paraqitur jeta e përafërt e përdorimit e aplikuar ndaj zërave të rëndësishëm të pronës, impianteve dhe paisjeve:

2.9 Prona, impiantet dhe paisjet (vazhdim)

	2017	2016
Mobiljet dhe paisjet	2-5 vite	2-5 vite
Paisjet e TI nën 1,000 Euro	3 vite	3 vite
Veturat	5 vite	5 vite

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurive ose janë njohur si pasuri të ndara, si ka qenë e përshtatshme, vetëm kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në Organizatë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Fitimet dhe humbjet mbi heqjet janë përcaktuar duke krahasuar shumat me vlerat bartëse. Këto janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.

2.10 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetëgjatësi të caktuar të cilat janë blerë veç e veç mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet në baza të njejta përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurisë.

Pasuritë e pa prekshme të Organizatës përmbajnë Softuerë kompjuterik, të drejtat autoriale për shfrytëzimin e librave dhe licence nga Agjensioni Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) Gjithashtu këto pasuri përfshijnë koston e përkthimit të librave të programit të auditimit të brendshëm e cila është kapitalizuar si kosto e zhvillimit në pajtueshmëri me SNK 38 Pasuritë e paprekshme.

Amortizimi është ngarkuar duke përdorur metodën drejtvizore brenda pesë viteve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

2.11 Dëmtimi i pasurive të prekshme dhe të paprekshme

Në fund të secilës periudhë raportuese, Organizata rishikon shumat bartëse të pasurive të prekshme dhe të pa prekshme të saj për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dëshmi që ato pasuri kanë humbje nga dëmtimi. Nëse ekziston ndonjë informacion i tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet në mënyrë që të përcaktohet masa e humbjeve nga dëmtimi (nëse ka).

Shuma e rikuperueshme është më e lartë se sa vlera e drejtë minus shpenzimet e hudhjes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës së përdorimit, rrjedhat e ardhshme të parasë së gatshme janë të skontuara në vlerën e tyre të tanishme duke përdorur normën e skontimit të para-tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe riskun specifik të pasurisë për të cilën vlerësimet e rrjedheve të ardhshme të parasë nuk kanë qenë të rregullura.

Nëse shuma e rikuperueshme e një pasurie vlerësohet të jetë më e vogël se vlera bartëse e saj, vlera bartëse e pasurisë zvogëlohet në shumën e rikuperueshme të saj. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim apo humbje, përveç rastit kur pasuria përkatëse mbahet me shumën e rivlerësuar, ku në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si rënje e rivlerësimit.

Pasuritë që janë subjekt i amortizimit janë rishikuar për dëmtim kurdo që ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos rikuperohet. Vlera bartëse e një pasurie është shënuar menjëherë në vlerë të rikuperueshme nëse vlera bartëse e një pasurie është më e lartë se vlera e rikuperueshme që është vlersuar të jetë. Vlera e rikuperueshme është më e larta e vlerës reale të pasurisë minus kosto e shitjes dhe vlerës në përdorim.

2.12 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njej si shpenzime koston përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompenzim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstruktoj apo të i njej pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.13 Instrumentet Financiare

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Organizata bëhet pjesë e marrëveshjeve kontraktuale të instrumenteve.

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e tyre të drejtë. Kostot e transaksioneve të cilat i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare u shtohen apo i zbriten vlerës së drejtë të pasurive financiare apo detyrimeve financiare, në mënyrë të përshtatshme në njohjen fillestare. Kostot e transaksioneve të atribueshme direkt blerjes së pasurive financiare apo detyrimeve financiare në vlerën e tyre të drejtë përmes fitimit apo humbjes njihen menjëherë në fitim apo humbje.

Pasuritë financiare

Pasuritë financiare klasifikohen në kategoritë specifike siç janë: pasuritë financiare 'në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes' (VDPFH), investimet 'e mbajtura deri në maturim', pasuritë financiare 'të gatshme-për-shitje' (GPSH) dhe 'huatë dhe të arkëtueshmet'. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i pasurive financiare dhe përcaktohet në kohën e njohjes fillestare. Të gjitha blerjet apo shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në bazë të datës së tregtimit. Blerjet apo shitjet në mënyrën e rregullt janë blerjet apo shitjet e pasurive financiare të cilat kërkojnë shpërndarjen e pasurive brenda kohës së caktuar nga rregullimi apo marrëveshja në treg.

Metoda efektive e interesit

Metoda efektive e interesit është metoda e kalkulimit të kostos së amortizuar të një instrumenti të borxhit dhe të alokimit të të hyrave nga interesi përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit e cila saktësisht skanton arkëtimet e ardhshme të parasë, të vlerësuar përmes jetës së pritur të instrumentit të borxhit, apo, ku është e përshtatshme, një periudhe më të shkurtër, vlerës neto bartëse në njohjen fillestare.

Të hyrat njihen në baza të interesit efektiv për instrumentet e borxhit, të ndryshme nga ato të cilat klasifikohen si VDPFH.

Pasuritë financiare të VDPFH

Pasuritë financiare klasifikohen si VDPFH kur pasuria financiare është (i) konsideratë kontigjente e cila mund të paguhet nga një blerje si pjesë e kombinimit të biznesit për të cilën aplikohet SNRF 3, (ii) të mbajtura për tregtim, ose (iii) janë të përcaktuara si VDPFH.

Investimet e mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivate me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe data fikse të maturimit, ku Organizata ka qëllim pozitiv dhe mundësi të i mbaj deri në maturim. Pas njohjes fillestare, investimet e mbajtura deri në maturim vlerësohen sipas kostos së amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit minus çfarëdo dëmtimi.

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë pasuri financiare jo-derivate me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në tregun aktiv. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme (duke përfshirë të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera, paranë e gatshme dhe paranë në bankë) vlerësohen sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, minus çfarëdo dëmtimi.

Pasuritë financiare të gatshme–për–shitje (pasuritë financiare GPSH)

Pasuritë financiare GPSH janë jo-derivate të cilat janë të përcaktuara sikur GPSH apo nuk klasifikohen si (a) huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, (b) investimet që mbahen deri në maturim apo (c) pasuritë financiare në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes

Dëmtimi i pasurive financiare

Pasuritë financiare, të ndryshme nga VDPFH, vlerësohen si indikatorë të dëmtimit në fund të secilës periudhë raportuese. Pasuritë financiare konsiderohen të dëmtuara kur ka dëshmi që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që ndodhin pas njohjes fillestare të pasurive financiare, janë ndikuar rrjedhat e ardhshme të parasë së gatshme të vlerësuara të investimeve.

Për instrumentet e ekuitetit GPSH, një rënje domethënëse apo e zgjatur në vlerën e drejtë të letrës me vlerë poshtë kostos së tij konsiderohet të jetë dëshmi e dëmtimit

Për të gjitha pasuritë e tjera financiare, dëshmi të vlefshme të dëmtimit mund të përfshijnë:

- Vështirësitë financiare domethënëse të emetuesit apo të palës tjetër;
- Prishja e kontratës, siç është mospagesa apo shkelja në pagesat e interesit apo kryegjësë;
- Mundësia që huamarrësi të ketë falimentim apo ri-organizim financiar; apo
- Humbja e një tregu aktiv për pasuritë financiare për shkak të vështirësive financiare.

Për disa kategori të pasurive financiare, siç janë llogaritë e arkëtueshme tregtare, pasuritë vlerësohen për dëmtim në baza kolektive edhe nëse individualisht nuk janë vlerësuar për dëmtim. Dëshmitë e vlefshme të dëmtimit për një portfolio të llogarive të arkëtueshme mund të përfshijnë përvojën e kaluar të mbledhjes së pagesave të Organizatës, një rritje në numrin e pagesa të vonuara në portfolio, si dhe ndryshimet e dukshme në kushtet ekonomike kombëtare apo lokale të cilat lidhen me mospagesën e llogarive të arkëtueshme.

Për pasuritë financiare të cilat vlerësohen sipas kostos së amortizimit, shuma e njohur e humbjeve nga dëmtimi është diferenca në mes të shumës bartëse të pasurisë në vlerën e tanishme dhe vlerës së tanishme të rrjedhës së parasë, e skontuar në normën efektive origjinale të pasurisë financiare.

Për pasuritë financiare që vlerësohen sipas kostos së amortizuar, nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga dëmtimi bie, dhe rënja mund të jetë e lidhur objektivisht me një ngjarje që ndodhë pas njohjes së dëmtimit, humbja nga dëmtimi i njohur në fillim kthehet mbrapsht përmes fitimit apo humbjes deri në masën që shuma e bartur e investimin në datën e dëmtimit të kthyer mbrapsht nuk e tejkalon shumën e kostos së amortizuar që do të kishte qenë nëse dëmtimi nuk do të ishte njohur.

Çnjohja e pasurive financiare

Organizata e çnjeh pasurinë financiare kur të drejtat kontraktuale të rrjedhës së parasë për largimin e pasurive, apo transferimin e pasurisë financiare dhe kryesisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së pasurisë i kalojnë palës tjetër.

Në çnjohje të plotë të pasurisë financiar, diferenca në mes të shumës bartëse të pasurisë dhe shumës së konsideratës së pranuar dhe llogarive të arkëtueshme dhe humbjet apo fitimet kumulative që ishin njohur në pasqyrën tjetër gjithëpërfshirëse dhe të akumuluar në ekuitet njihet në fitim apo humbje.

Detyrimet financiare

Detyrimet financiare klasifikohen si detyrime financiare 'VDPFH' apo 'detyrime financiare të tjera'

Detyrimet financiare VDPFH

Detyrimet financiare klasifikohen si VDPFH kur detyrimi financiar është (i) konsiderata kontigjente e cila mund të paguhet në blerje si pjesë e kombinimit biznesor për të cilën aplikohet SNRF 3, (ii) të mbajtura për tregtim, apo (iii) është e përcaktuar si VDPFH.

Detyrimet financiare të tjera

Detyrimet financiare të tjera (përfshirë huazimet dhe të pagueshmet tregtare dhe të tjera) janë më pas të vlerësuara me koston së amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit.

Çnjohja e detyrimeve financiare

Organizata i çnjeh detyrimet financaire kur, dhe vetëm kur obligimet e Organizatës shkarohen, anulohen apo shuhet. Diferenca në mes të shumës bartëse të detyrimit financiar të çnjohur dhe konsiderata e paguar dhe të pagueshmet njihen tek fitimi dhe humbja.

2.14 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur kur kanë ndodhur.

2.15 Benefitet e të punësuarve

Organizata kontribon në planet pas pensionale të të punësuarve të saj siç përshkruhen nga legjislacioni i sigurimit i miratuar nga ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Kontributet, e bazuara në paga, u janë bërë organizatës nacionale që janë përgjegjëse për pagesën e pensioneve. Nuk ka detyrim shtesë në lidhje me këto plane dhe kështu këto skema janë konsideruar si plane të definuara të kontributeve. Organizata nuk ka benefite pas pensionale ndaj të punësuarve të saj.

2.16 Tatimi në fitim

SHKÇAK është krijuar si organizatë jo profitabile dhe prandaj, është e liruar nga tatimi në të ardhura të korporatave. SHKÇAK gjatë vitit 2017 nuk ka gjeneruar të hyra tjera nga aktivitetet ekonomike të cilat i nënshtrohen tatimit në të ardhura të korporatave.

Organizata nuk ka njohur ndonjë detyrim apo pasuri të shtyrë tatimor me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016, siç nuk ka ndryshime të përkohshme ekzistuese në ato data.

2.17 Menaxhimi i riskut financiar

Risku kreditor

Risku kreditor paraqet riskun që pala tjetër të dështoj në kryerjen e obligimeve kontraktuale që rezulton në humbje financiare të Organizatës. Organizata ka adoptuar një politikë për të kontraktuar vetëm palët e besueshme dhe të siguroj dëshmi të mjaftueshme, për të zvogëluar rrezikun e humbjes financiare nga dështimi në kryerjen e pagesave. Organizata siguron që njeh vetëm të arkëtueshmet nga individët e organizatave të mirë-formuara në Kosovë. Ekspozimi ndaj kredive kontrollohet në baza periodike nga Zyrtari Ekzekutiv dhe Këshilli.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i cili ndryshon me ndryshimin e çmimeve të tregut, siç janë ndryshimi i kursit valuator i jashtëm dhe i normave të interesit që do të ndikojnë në të hyrat e Organizatës apo vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiare të saj. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregut është menaxhimi dhe kontrollimi i ekspozimit të riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, gjatë optimizimit të kthimit. Përderisa nuk ka transaksione materiale në valutën e huaj dhe përderisa nuk ka interes në fondet e huazuara nga institucionet financiare lokale dhe të jashtme në datën e pozicionit financiar, Organizata nuk ekspozohet ndaj çfarëdo ndryshimi të kursit të këmbimit dhe rrezikut të normave të interesit.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Pasuritë		
Paraja e gatshme dhe në bankë	449,459	490,163
Totali	449,459	490,163

Risku i likuiditetit

Përgjegjësia themelore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit i takon Këshillit të ShKÇAK. Menaxhimi i matur i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parasë së gatshme, disponueshmëri të fondeve përmes lehtësirave për kredi dhe mundësisë për t'i mbledhur në kohën e duhur, brenda kushteve të shumave të vendosura për shkak të konsumatorëve. Organizata menaxhon riskun e likuiditetit duke mbajtur rezerva të mjaftueshme, lehtësira bankare dhe duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme planifikimin dhe rrjedhën aktuale të parasë, dhe duke koordinuar profilet e maturitetit të pasurive dhe detyrimeve financiare.

Tabelat në vijim paraqesin maturitetet kontraktuale të mbetura të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të Organizatës. Tabelat përgatiten në baza të rrjedhave të parasë të paskontuara të detyrimeve financiare.

	31 Dhjetor 2017			
	Qarkulluese	Jo - qarkulluese		
	Deri në 1 vit	1 deri 2 vite	2 deri 5 vite	Mbi 5 vite
	(Euro)	(Euro)	(Euro)	(Euro)
Pasuritë financiare				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	449,459	-	-	-
Llogaritë e arkëtueshme	3,676			
Totali i pasurisë	453,135	-	-	-
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	10,538			
Totali i detyrimeve financiare	10,538	-	-	-

	31 Dhjetor 2016			
	Qarkulluese	Jo - qarkulluese		
	Deri në 1 vit	1 deri 2 vite	2 deri 5 vite	Mbi 5 vite
	(Euro)	(Euro)	(Euro)	(Euro)
Pasuritë financiare				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	490,163	-	-	-
Llogaritë e arkëtueshme	5,662			
Totali i pasurive financiare	495,825	-	-	-
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	17,641	-	-	-
Totali i detyrimeve financiare	17,641	-	-	-

Instrumentet financiare që nuk paraqiten në vlerën e drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe vlerat e drejta të pasurive dhe detyrimeve financiare që nuk paraqiten në Pasqyrën e pozitës financiare në vlerën e tyre të drejtë:

	Vlera bartëse 2017	Vlera e drejtë 2017	Vlera bartëse 2016	Vlera e drejtë 2016
Pasuritë financiare				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	449,459	449,459	490,163	490,163
Llogaritë e arkëtueshme	3,676	3,676	5,662	5,662
Totali i pasurive financiare	453,135	453,135	495,825	495,825
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	10,537	10,537	17,641	17,641
Totali i detyrimeve financiare	10,537	10,537	17,641	17,641

2.18 Ngjarjet pasuese

Ngjarjet pas përfundimit të vitit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e Organizatës në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarje pas përfundimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në pasqyra financiare kur kanë qenë materiale.

3 Të hyrat

	(në Euro)	
	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2017	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2016
Regjistrimi	6,720	9,260
Trajnimet – sektori privat	161,630	203,280
Provimet – sektori privat	74,840	79,530
Provimet – sektori publik	2,000	3,250
Trajnime – auditimi i brendshëm	42,710	
Provime – auditimi i brendshëm	1,750	
Trajnimet – forenzika (UNDP)	16,200	
Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	23,434	21,915
Gjithsej të hyra nga edikimi	329,284	317,235
Të hyrat nga anëtarësimi	105,526	122,115
Gjithsej të hyrat nga anëtarësimi	105,526	122,115
Të hyrat tjera	5,531	7,450
Te hyra nga granti BQK		5,788
Të hyrat nga kontrolli i cilësisë	6,200	4,800
Te hyrat nga forumi		10,300
Gjithsej të hyrat	446,541	467,688

4 Shpenzimet administrative

	(në Euro)	
	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2017	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2016
Pagat	115,641	105,943
Zhvlersimi (Shënimi 10)	4,094	4,369
Amortizimi (Shënimi 11)	8,471	230
Qiraja	10,800	10,800
Shërbimet komunale	2,577	3,193
Shpenzime të komunikimit	2,891	2,668
Furnizime të zyrës	2,352	2,769
Auditimi	2,722	2,583
Renovimi i zyrës	690	1,217
Sigurimi shëndetësor	1,465	2,322
Mirëmbajtja e veturës	3,186	3,337
Zhvillimi i personelit	-	1,099
Shpen.e borxheve të këqija	1,070	1,052
Reprezentacion	5,236	5,942
Shpenzimet tjera	569	3,740
Gjithsej shpenzimet administrative	161,764	151,264

5 Shpenzimet e trajnimit

Shpenzimet e trajnimit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 ishin si në vazhdim:

	(në Euro)	
	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2017	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2016
Mbajtja e trajnimeve	80,182	94,475
Qiraja	19,800	22,800
Shtypja e materialeve	9,280	9,235
Shpenzimet e trajnimit – sek publik	17,334	19,346
Shpenzimet e rrymes – trajnime	2,321	2,191
Te drejtat autoriale nga BPP, perkthimi dhe azhurnimi	7,944	11,705
Shpenzimet e auditimi te brendshem	11,696	1,576
Tjera	5,300	2,113
Gjithsej shpenzimet e trajnimeve	153,858	163,441

6 Shpenzimet e provimeve

	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2017	(në Euro) Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2016
Përpilimi, korrigjimi	11,234	9,900
Mbikqyrja	6,252	6,297
Qiraja	2,160	2,160
Shtypja	2,507	2,592
Shpenzimet e provimeve sek publik	473	1,995
Tjera	708	566
Gjithsej shpenzimet e provimeve	23,334	23,510

7 Shërbimi për anëtarë

	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2017	(në Euro) Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2016
Edukimi i vazhdueshëm profesional	14,966	26,734
Këshilli dhe komisionet	4,946	7,791
Udhëtimet	19,404	15,627
Takimet vjetore dhe ceremonia e fundvitit	10,949	11,640
Anëtarësia në organizata	15,279	14,190
Seminare dhe punëtori	6,888	5,725
Pagat – shërbimi për anëtarë	25,067	28,407
Shpenzimet e kontrollit të cilësive	24,534	21,473
Marketingu	2,814	1,715
Ueb-faqja dhe TI	2,818	2,989
Gjithsej shpenzimet për anëtarë	127,665	136,291

8 Paraja dhe ekuivalentet e parashë

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor	
	2017	2016
Llogari rrjedhëse - Pro Credit Bank	12,895	30,742
Llogari rrjedhëse - Banka Private Biznesit	77,706	100,517
Llogari rrjedhëse - Banka Private Biznesit USD	49	77
Llogari rrjedhëse - Banka Ekonomike	108,809	108,827
Depozitat afatshkurta te depozituara	250,000	250,000
	449,459	490,163

9 Parapagimet

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor	
	2017	2016
Parapagimet	5,629	4,837
	5,629	4,837

10 Të arkëtueshmet

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor	
	2017	2016
Të arkëtueshmet nga anëtarët	4,085	6,291
Të tjera		-
Minus: Provisioni për të arkëtueshmet e këqia dhe të dyshimta nga anëtarët	(409)	(629)
	3,676	5,662

11 Prona, impiantet dhe paisjet

	Kompjuteret dhe pajisjet tjera	Automjeti	Totali
KOSTO			
Me 01 Janar 2016	60,943	12,666	73,609
Blerjet gjate vitit	2,028		2,028
Me 31 Dhjetor 2016	62,971	12,666	75,637
Me 01 Janar 2017	62,971	12,666	75,637
Blerjet gjate vitit	3,987		3,987
Me 31 Dhjetor 2017	66,958	12,666	79,624
Zhvleresimi I Akumuluar			
Me 01 Janar 2016	(52,568)	(12,666)	(65,234)
Zhvleresimi I vitit	(4,369)		(4,369)
Me 31 Dhjetor 2016	(56,937)	(12,666)	(69,603)
Zhvleresimi I Akumuluar			
Me 01 Janar 2017	(56,937)	(12,666)	(69,603)
Zhvleresimi I vitit	(4,094)		(4,094)
Me 31 Dhjetor 2017	(61,031)	(12,666)	(73,697)
Vlera neto ne libra			
Me 31 Dhjetor 2016	6,034	0	6,034
Me 31 Dhjetor 2017	5,927	0	5,927

12 Pasuritë e patrupëzuara

	Me 31 Dhjetor 2017	Me 31 Dhjetor 2016
Me 01 janar		
Kosto	77,898	41,037
Shtesat gjatë vitit	1,288	36,861
Me 31 Dhjetor	79,186	77,898
Amortizimi i akumuluar		
Me 01 Janar	(40,807)	(40,577)
Amortizimi i vitit	(8,471)	(230)
Me 31 Dhjetor	(49,278)	(40,807)
Vlera neto në libra		
Me 01 Janar	37,091	460
Me 31 Dhjetor	29,908	37,091

13 Detyrimet tregtare dhe të tjera

	Me 31 Dhjetor 2017	(në Euro) Me 31 Dhjetor 2016
Detyrimet për kontributin e tatimit të të ardhurave personale mbi pagat	7,365	9,758
Detyrimet për shërbimet e auditimit	2,652	2,583
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	304	5,084
Të pagueshme ndaj punonjësve	216	216
	10,537	17,641

14 Të hyrat e shtyra

Analiza e balancës

Me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016, balanca e të hyrave të shtyra përbëhet si në vazhdim:

	(në Euro)	
	Me 31 Dhjetor 2017	Me 31 Dhjetor 2016
Tarifat e shtyra të edukimit	93,677	115,181
Grantet e shtyra:		
- Granti BQK	50	50
	93,727	115,231

15 Zotimet dhe Kontingjentet

Zotimet

Nuk ka zotime me 31 Dhjetor 2017 përveç marrëveshjes së qerasë së zyrës dhe sallave të trajnimit. Pagesa mujore e qerasë për zyre dhe sala të trajnimeve është 2,800 Euro.

Çështjet gjyqësore

Me 31 Dhjetor 2017 nuk është llogaritur asnjë provision për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i Organizatës, rregullisht analizon risqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjyqësore dhe pretendimet e mundshme kundër Organizatës, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Organizatës beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

16 Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonje ngjarje pas dates së raportimit që kërkon korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare.



SCAAK / ShKÇAK



SCAAK



SCAAK / ShKÇAK



SCAAK / ShKÇAK

www.scaak.org